FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 82

Tiranë – E enjte, 7 maj 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 44/2020 datë 23.4.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri.....	4577
Dekret i Presidentit nr.11476, datë 4.5.2020	Për shpallje ligji.....	4613
Ligj nr. 46/2020 datë 23.4.2020	Për ratifikimin e protokollit shtesë 6 mbi tregtinë e shërbimeve të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore.....	4613
Dekret i Presidentit nr.11473, datë 30.4.2020	Për shpallje ligji.....	4671
Ligj nr. 47/2020 datë 23.4.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes për një hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit të rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës.....	4671
Dekret i Presidentit nr. 11474, datë 30.4.2020	Për shpallje ligji.....	4676

LIGJ
Nr. 44/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11476, datë 4.5.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

KOPJA E NËNSHKRUAR

(Numri i veprimit 50123)

MARRËVESHJE HUAJE
(KONEKTIVITETI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE NË SHQIPËRI)
ndërmjet
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
dhe
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë 10 shkurt 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET
Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde
Seksioni 1.02. Përkufizime
Seksioni 1.03. Interpretimi

NENI II - TERMAT KRYESORE TË HUASË
Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha
Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të Huasë
Seksioni 2.03. Tërheqjet
Seksioni 2.04. Përfaqësuesi i Autorizuar

NENI III - EKZEKUTIMI I PROJEKTIT
Seksioni 3.01. Angazhime të tjera Afirmuese të Projektit
Seksioni 3.02. Njësia e Zbatimit të Projektit
Seksioni 3.03. Prokurimi
Seksioni 3.04. Angazhimet për Përputhshmërinë Mjedisore dhe Sociale
Seksioni 3.05. Konsulentët
Seksioni 3.06. Shpeshtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Dorëzimit

NENI IV - PËRCAKTIMET FINANCIARE
Seksioni 4.01. Regjistrat dhe Raportimi Financiar

NENI V - PEZULLIMI, PËRSHPEJTIMI, ANULIMI
Seksioni 5.01. Pezullimi
Seksioni 5.02. Përshpejtimi i Maturimit

NENI VI - HYRJA NË FUQI
Seksioni 6.01. Parakushtet për Hyrjen në Fuqi
Seksioni 6.02. Ndërprerja për Shkak të Pamundësisë për Hyrjen në Fuqi

NENI VII - DISBURSIMET
Seksioni 7.01 Parakushtet për Disbursimin e Parë
Seksioni 7.02 Parakushtet për disbursimin e Financimit të Pjeses D të Projektit

NENI VIII - TË NDRYSHME
Seksioni 8.01. Njoftimet

SKEDULI 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

SKEDULI 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET

SKEDULI 3 - PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE e lidhur në datën 10 shkurt 2020 ndërmjet **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** ("Huamarrësi") dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** ("Banka").

PREAMBULË

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE: Banka është themeluar për të ofruar financime për projekte specifike, me qëllim nxitjen e kalimit në ekonomi të orientuara drejt tregut të hapur dhe për të promovuar nisma private dhe sipërmarrëse në disa vende të caktuara, të cilat janë zotuar të respektojnë dhe zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizimit dhe ekonomisë së tregut;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE: Huamarrësi synon të zbatojë Projektin e përshkruar në Skedulin 1, i cili është konceptuar për ta ndihmuar Huamarrësin në rehabilitimin dhe përmirësimin e tre seksioneve të rrugëve rajonale dhe lokale në Republikën e Shqipërisë;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE: Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE: Banka është në proces për t'i ofruar Huamarrësit fonde për bashkëpunim teknik në formën e grantit për ta ndihmuar me zbatimin e projektit dhe zhvillimin e programit të qëndrueshëm dhe të ekoturizmit, në bazë të termave dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit; dhe se

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE: Banka ka rënë dakord, ndër të tjera, bazuar në sa më sipër, që t'i japë hua Huamarrësit shumën prej deri në 50,000,000 dollarë amerikanë, në bazë të termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

NË VIJIM TË SA MË SIPËR, Palët bien dakord si më poshtë:

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 tetor 2018 janë bërë pjesë dhe zbatohen për këtë Marrëveshje njëlloj sikur të ishin parashikuar plotësisht në këtë Marrëveshje, pavarësisht ndryshimeve të mëposhtme (këto dispozita të ndryshuara si më poshtë referohen në vijim si "Termat dhe Kushtet Standarde"):

(a) Përkufizimi i "Shumës së Disponueshme" në Seksionin 2.02 të Termave dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet dhe ka tekstin e mëposhtëm:

"Shuma e Disponueshme" nënkupton shumën e Transhit 1 të Huasë, e cila nuk është anuluar ose tërhequr apo nuk ka qenë objekt Angazhimi për Rimbursim të Kushtëzuar apo të Pakushtëzuar, plus, pas Datës së Disponueshmërisë së Transhit 2, shumën e Transhit 2 të Huasë, e cila nuk është anuluar ose tërhequr apo nuk ka qenë objekt Angazhimi për Rimbursim të Kushtëzuar apo të Pakushtëzuar (të gjitha termat me shkronja të mëdha në këtë përkufizim për të cilat nuk jepen përkufizime, kanë kuptimin që i jepet në Marrëveshjen e Huasë)

(a) Seksioni 3.05 i Termave dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet dhe ka tekstin e mëposhtëm:

Seksioni 3.05. Tarifa e Angazhimit dhe Komisioni Paraprak

(a) Huamarrësi i paguan Bankës Tarifën e Angazhimit të pagueshme për Shumën e Disponueshme sipas normës së përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë, plus çdo shumë të Huasë që është objekt i Angazhimit për Rimbursim dhe që nuk është tërhequr ende, me kusht që Tarifa e Angazhimit që paguhet për shumën e Huasë, në bazë të Angazhimit për Rimbursim të Pakushtëzuar, të jetë 0.5% më e madhe në vit sesa norma e Tarifës së Angazhimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë. Tarifa e Angazhimit mblidhet:

(1) për Transhin 1, nga data pas gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së Marrëveshjes së Huasë dhe

(2) për Transhin 2, nga data pas shtatë (7) ditësh pas datës së Disponueshmërisë së Transhin 2 dhe

(3) në rastin e Tarifës së Angazhimit që paguhet për shumën e Huasë në bazë të Angazhimit për Rimbursim të Pakushtëzuar, nga data e lëshimit të këtij Angazhimi për Rimbursim të pakushtëzuar;

me kusht që Tarifa e Angazhimit të mblidhet dhe të llogaritet mbi baza të njëjta si interesi në seksionin 3.04(b)(ii). Tarifa e Angazhimit paguhet në Datën e Pagesës së Interesit (megjithëse në këtë datë mund të mos paguhet asnjë interes), duke filluar me Datën e Parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Fillimit.

(b) Huamarrësi i paguan Bankës komisionin paraprak të barasvlershëm me një për qind (1%) të shumës së principalit, përkatësisht të Transhit 1 dhe Transhit 2 të Huasë.

(c) Në emër të Huamarrësit, Banka kryen tërheqje nga Shuma e Disponueshme e Transhit 1 në Datën e Fillimit ose pas brenda shtatë (7) ditësh dhe i paguan vetes shumën e Komisionit Paraprak që paguhet për Transhin 1 sipas Seksionit 3.05(b);

(d) Në emër të Huamarrësit, Banka kryen tërheqje nga Shuma e Disponueshme e Transhit 2 në Datën e Disponueshmërisë së Transhit 2 ose pas brenda shtatë (7) ditësh dhe i paguan vetes shumën e Komisionit Paraprak që paguhet për Transhin 2 sipas Seksionit 3.05(b);

(e) Të gjithë termat me shkronja të mëdha në Seksionin 3.05 që nuk janë përkufizuar, kanë kuptimin që i jepet në Marrëveshjen e Huasë".

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kurdo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe në Preambulë dhe Skedule), përveç kur përkufizohen ndryshe apo kur konteksti kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në Preambulë kanë kuptimin që i jepet në Preambulë, termat e përkufizuar në Termat dhe Kushtet Standarde kanë kuptimet përkatëse që i jepen në Termat dhe Kushtet Standarde, si dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Autorizim" nënkupton çdo pëlqim, regjistrim, depozitim, marrëveshje, noterizim, certifikatë, miratim, leje, dhënie autoriteti apo përjashtim nga ose me çdo Autoritet Qeveritar, qoftë i dhënë apo i padhënë përmes veprimeve, apo i konsideruar i dhënë apo i padhënë përmes mosveprimeve brenda afatit të caktuar kohor, dhe nëse janë të zbatueshme, miratimet dhe pëlqimet e kreditorëve.

"Plan i Menaxhimit të Biodiversitetit" është Plani i Menaxhimit të Biodiversitetit, datë 9 shtator 2019, pjesë e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social.

"Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit" është Ministri i Financave dhe Ekonomisë së Huamarrësit.

"Kërkesat e Përcaktuara të Performancës" janë Kërkesat e Performancës nga 1-shi deri te 8-ta, si dhe 10-ta (ose, në varësi të kontekstit, secila prej këtyre Kërkesave të Përcaktuara të Performancës) të Kërkesave të Performancës të majit 2014 dhe lidhur me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës, të muajit maj 2014.

"Rregullat e Prokurimit të BERZH-it" janë Politikat dhe Rregullat e Prokurimit të Bankës të datës 1 nëntor 2017.

"Politika dhe Procedura e Zbatimit të Detyruar" janë Politika dhe Procedura e Zbatimit të Detyruar të Bankës, datë 4 tetor 2017.

"Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social" është plani i masave zbutëse dhe përmirësuese mjedisore dhe sociale (duke përfshirë Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit të shtatorit 2019, Kuadrin e Politikës së Sistemimit dhe Planet e Rivendosjes të Mjeteve të Jetesës dhe Risistemimit, datë 1 tetor 2019, kopja e të cilave gjendet bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje në Shtojcën 3, miratuar nga Banka në përputhje me Seksionin 3.04(b), plan i cili mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin me shkrim të Bankës, në përputhje me Seksionin 3.04(c).

"E Drejta Mjedisore dhe Sociale" është çdo ligj apo rregullore e zbatueshme që lidhet me:

(a) ndotjen apo mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe ligjet apo rregulloret përkatëse që lidhen me pjesëmarrjen në vendimmarrje;

(b) kushtet e punës dhe punësimit;

(c) shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës;

(d) shëndetin, sigurinë dhe sigurimin publik;

(e) indigjenët;

(f) trashëgiminë kulturore ose

(g) risistemimin apo zhvendosjen ekonomike të njerëzve.

"Çështja Mjedisore dhe Sociale" është çdo çështje që është objekt i të Drejtës Mjedisore dhe Sociale, çdo Kërkese të Përcaktuar Performance ose Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social.

"Enti zbatues" është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

"Viti Fiskal" është viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

"Autoritet Qeveritar" është qeveria e Huamarrësit apo çdo nëndivizion politik i saj, qoftë agjenci, autoritet, degë ose departament shtetëror, rajonal dhe vendor; organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore apo çdo subjekt tjetër që ushtron autoritet ose funksione ekzekutive, ligjvënëse, gjyqësore, tatimore, rregullatore ose administrative, i ose që i përket qeverisë

apo çdo nëndivizioni të saj (duke përfshirë çdo organ mbikombëtar), si dhe të gjithë zyrtarët, agjentët apo përfaqësuesit e sa më sipër.

"Plani Afatmesëm i Biznesit" është Plani Buxhetor Afatmesëm që përgatitet çdo vit dhe përditësohet çdo gjashtë muaj nga FSHZH-ja.

"NJZP" është njësia e zbatimit të projektit, e referuar në Seksionin 3.02.

"Transhi 1" ka kuptimin që i është dhënë në Seksionin 2.01(b)(1).

"Transhi 2" ka kuptimin që i është dhënë në Seksionin 2.01(b)(2).

"Data e Disponueshmërisë së Transhit 2" është data në të cilën Transhi 2 është angazhuar dhe është bërë i disponueshëm për Tërheqje, sipas njoftimit të Huamarrësit nga Banka, ndër të tjera, në bazë të plotësimit të kushteve paraprake të përcaktuara në Seksionin 7.02.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referimi që i bëhet një Neni, Seksioni apo Shtojce, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referim ndaj atij Neni, Seksioni apo Shtojce specifike në këtë Marrëveshje.

NENI II - TERMAT E PRINCIPALIT TË HUASË

Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

(a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej deri në 50,000,000 dollarë amerikanë.

(b) Huaja ndahet në dy Transhe, si më poshtë:

(1) Transhi 1 në shumën prej deri në 40,000,000 dollarë amerikanë dhe

(2) Transhi 2 në shumën prej deri në 10,000,000 dollarë amerikanë.

(c) Pavarësisht çdo kundërshtie në këtë Marrëveshje, qoftë e shprehur apo e nënkuptuar, Transhi 2 i Huasë është i paangazhuar dhe rrjedhimisht, Banka nuk ka asnjë detyrim që të kryejë ndonjë disbursim apo të vijojë me tërheqjet në kuadër

të Transhit 2 të Huasë, nëse Data e Disponueshmërisë së Transhit 2 nuk është në përputhje me termat dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të Huasë

(a) Shuma Minimale e Tërheqjes është 250,000 dollarë amerikanë.

(a) Shuma Minimale e Parapagimit është 1,000,000 dollarë amerikanë.

(a) Shuma Minimale e Anulimit është 1,000,000 dollarë amerikanë.

(d) Datat e Pagesës së Interesit janë 10 marsi dhe 10 shtatori i çdo viti.

(e) (1) Huamarrësi e shlyen Transhin 1 në njëzet e dy këste të barabarta (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) që paguhen çdo gjashtë muaj në datat 10 mars dhe 10 shtator të çdo viti, ku Data e Parë e Shlyerjes së Huasë për Transhin 1 është 10 mars 2024 dhe Data e Fundit e Shlyerjes së Huasë për Transhin 1 është 10 shtator 2034.

(2) Huamarrësi e shlyen Transhin 2 në njëzet e dy këste të barabarta (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) që paguhen çdo gjashtë muaj në datat 10 mars dhe 10 shtator të çdo viti, ku Data e Parë e Shlyerjes së Huasë për Transhin 2 është Data e Parë e Pagesës së Interesit që bie në datën apo menjëherë pas datës së përvjetorit të 4-t të datës së njoftimit të Bankës për fillimin e Periudhës së Disponueshmërisë së Transhit 2 dhe Data e Fundit e Shlyerjes së Huasë për Transhin 2 është (i) Dita e Parë e pagesës pas datës së 15 vjetorit të datës së njoftimit të Bankës për fillimin e Periudhës së Disponueshmërisë së Transhit 2 ose (ii) Data e Pagesës së Interesit që paraprin datën e 15 vjetorit të datës së njoftimit të Bankës për fillimin e Periudhës së Disponueshmërisë së Transhit 2 (sipas rastit).

(3) Pavarësisht sa më sipër, në rast se (i) Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e Transhit 1 dhe/ose Transhit 2, sipas rastit, përpara Datës së Parë të Shlyerjes së Huasë për Transhet përkatëse, të përcaktuar në Seksionin 2.02(e), dhe (ii) në rast se Banka e shtyn Datën e Fundit të Disponueshmërisë për secilën prej Transheve, të përcaktuar në Seksionin 2.02(f), në një datë që bie pas Datës së Parë të Shlyerjes së Huasë për atë Transh, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të kryer në kuadër të atij Transhi në Datën apo pas Datës së Parë të Shlyerjes së Huasë për atë Transh alokohet për shlyerje në shuma të barabarta në disa Data për Shlyerjen e Huasë për atë Transh që bien pas datës së tërheqjes (Banka i përshtat shumat e alokuara sipas nevojës për të arritur numrin e plotë në çdo rast). Banka e njofton Huamarrësin për këto alokime herë pas here.

(f) (1) Data e Fundit e Disponueshmërisë për Transhin 1 është 10 shkurt 2024 ose kjo datë mund të vendoset nga Banka pasi të ketë marrë kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi dhe pasi ta ketë njoftuar Huamarrësin.

(2) Data e Fundit e Disponueshmërisë për Transhin 2 është më e hershmja nga: (i) përvjetori i 4-t nga data e njoftimit të Bankës për fillimin e Periudhës së

Disponueshmërisë së Transhit 2, ose (ii) 31 dhjetor 2027, një datë e mëvonshme që Banka mund të vendosë pasi të ketë marrë kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi dhe pasi ta ketë njoftuar Huamarrësin.

(3) Nëse e gjithë apo një pjesë e Shumës së Disponueshme është objekt i një Norme Fikse Interesi dhe banka e shtyn Datën e Fundit të Disponueshmërisë, Huamarrësi ia paguan këtë shumë Bankës në kohë me Koston e Shtyrjes, sipas njoftimit periodik të Bankës me shkrim për Huamarrësin.

(g) Norma e Tarifës së Angazhimit është 0.5% në vit.

(h) Huaja është objekt i Normës së Ndryshueshme të Interesit. Pavarësisht sa më sipër, Huamarrësi, si alternativë për pagimin e interesit me Normë Interesi të Ndryshueshme apo një pjese të Huasë së pashlyer, mund të zgjedhë të paguajë një Normë Fikse Interesi për këtë pjesë të Huasë, në përputhje me Seksionin 3.04(c) të Termave dhe Kushteve Standarde.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

Shuma e disponueshme mund të tërhiqet në përputhje me dispozitat e Skedulit 2 për të financuar (1) shpenzimet e kryera (ose, nëse Banka bie dakord, që do të kryhen) lidhur me koston e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe (2) Komisionet Paraprake.

Seksioni 2.04. Përfaqësuesi i Autorizuar

Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit është Ministri i Financave dhe Ekonomisë së Huamarrësit, me qëllim marrjen e veprimeve të kërkuara apo të lejuara në kuadër të dispozitave të Seksionit 2.03(a) dhe dispozitave të Seksioneve 3.01 dhe 3.02 të Termave dhe Kushteve Standarde.

NENI III - EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Seksioni 3.01. Angazhime të Tjera Afirmuese të Projektit

Krahas angazhimeve të përgjithshme të parashtruara në Nenin IV të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

(a) ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të ofruar fondet e mjaftueshme për përfundimin e Projektit;

(b) siguron që Enti Zbatues të realizojë menaxhimin ditor të Projektit, nëpërmjet NJZP-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në menaxhimin e konsoliduar financiar dhe prokurues;

(c) siguron që Enti Zbatues të përmbushë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

(d) ofron ose siguron ofrimin e të gjitha liçensave, miratimeve apo pëlqimeve qeveritare që duhen siguruar për financimin dhe realizimin e projektit dhe aktiviteteve të tij, duke përfshirë, pa asnjë kufizim, të gjitha lejet dhe liçencat e nevojshme për të garantuar të drejtën e kalimit dhe të drejtat e tjera të përdorimit të tokës për zbatimin e Projektit;

(e) siguron që Enti Zbatues t'i ofrojë Bankës jo më vonë se 31 dhjetori pas përvjetorit të parë të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Planin Afatmesëm të Biznesit që të jetë i kënaqshëm për Bankën, dhe që do të përditësohet dhe do t'i jepet Bankës jo më vonë se 31 dhjetori i çdo viti;

(f) siguron që Enti Zbatues të miratojë deri më 31 mars 2021 planin e rehabilitimit dhe mirëmbajtjes për njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në vendndodhjen e Projektit dhe pas përditësimit të raportit të vlerësimit të mirëmbajtjes së financuar nga BERZH-i;

(g) siguron që Enti Zbatues të miratojë një kontratë të standardizuar dhe të thjeshtë për mirëmbajtjen e shërbimeve deri më 31 mars 2021 midis njësive të qeverisjes dhe kontraktorëve në vendndodhjet e projektit.

(h) siguron që Enti Zbatues të përfshijë në dokumentacionin e tenderit kërkesën që kontraktuesit të ofrojnë, brenda mundësive dhe pa kosto shtesë, mundësi trajnimi për të paktën 60 të rinj gjatë fazës së ndërtimit lidhur me Projektin; dhe

(i) siguron që Enti Zbatues, pas përfundimit të zbatimit fizik të Pjesës A dhe B të Projektit (siç përcaktohet në Skedulin 1), të ketë arritur, brenda mundësive dhe pa kosto shtesë, trajnimin e të paktën 60 të rinjve nga kontraktuesit në lidhje me Projektin.

Seksioni 3.02. Njësia e Zbatimit të Projektit

Për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë edhe prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin, si dhe kërkesat mjedisore dhe sociale, Huamarrësi, përveç kur është rënë dakord ndryshe me Bankën, nxit Entin Zbatues që të krijojë dhe të vërë në funksionim një njësi për zbatimin e projektit, me burime të përshtatshme dhe personel të kualifikuar, të konsideruar në çdo rast si të përshtatshëm për Bankën.

Seksioni 3.03. Prokurimi

Për qëllimet e Seksionit 4.03 të Termave dhe Kushteve Standarde, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, metoda e prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga produktet e Huasë rregullohet nga dispozitat e mëposhtme:

(a) mallrat, punimet dhe shërbimet (përveç shërbimeve të konsulentëve që përfshihen në Seksionin 3.03(c)), prokurohen përmes një tenderi të hapur;

(b) për qëllimet e Seksionit 3.03(a), procedurat e tenderit të hapur, tenderit të hapur të thjeshtuar dhe kontraktimi i drejtpërdrejtë përcaktohen në Seksionin III të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it;

(c) konsulentët që do të punësohen nga Enti Zbatues për të asistuar në zbatimin e Projektit përzgjidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në Seksionin V të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it dhe

(d) të gjitha kontratat janë objekt i procedurave të rishikimit të përcaktuara në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe i rishikimeve paraprake nga Banka.

Seksioni 3.04. Angazhimet për Përputhshmërinë Mjedisore dhe Sociale

Pa e kufizuar përgjithësueshmërinë e Seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

(a) Huamarrësi, drejtpërdrejt, përmes Entit Zbatues apo mënyrave të tjera (si të çmohet e përshtatshme) siguron që çdo kontraktues ta zbatojë Projektin në përputhje me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, Ligjet Mjedisore dhe Sociale dhe të gjitha lejet, liçencat, çertifikatat dhe miratimet përkatëse mjedisore;

(b) pa kufizuar sa më sipër, Huamarrësi zbaton dhe respekton me kujdes drejtpërdrejt përmes Entit Zbatues apo mënyrave të tjera (si të çmohet e përshtatshme) Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe monitoron zbatimin e këtij plani në përputhje me dispozitat për monitorimin që parashtrohen në atë plan;

(c) Huamarrësi dhe Banka mund të bien dakord që herë pas here ta ndryshojnë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social në përgjigje të ndryshimeve të rrethanave të Projektit apo Huamarrësit, rasteve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit.

(d) Pa kufizuar përgjithësueshmërinë e sa më sipër:

(1) nëse ka ndonjë ndikim apo çështje negative mjedisore ose sociale që nuk është parashikuar apo marrë parasysh në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social për sa i përket tërësisë apo shkallës së saj,

(2) nëse ndonjë masë zbutëse e parashikuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social nuk është e mjaftueshme për të eliminuar apo reduktuar ndikimin mjedisor apo social në nivelin e parashikuar nga Kërkesat e Përcaktuara të Performancës brenda afatit kohor të përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social apo

(3) nëse është identifikuar ndonjë mospërmbushje materiale me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose me të drejtën mjedisore dhe sociale nga inspektimi i autoritetit rregullator apo ligjzbatues ose nga auditimi,

Huamarrësi, sapo të jetë e praktikueshme në mënyrë të arsyeshme dhe të ketë marrë pëlqimin e Bankës, zhvillon dhe përfshin në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social masat zbutëse shtesë apo të rishikuara, të cilat mund të jenë të nevojshme për të arritur përputhshmërinë me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, të cilat në çdo rast duhet të jenë të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.05. Konsulentët

(a) për të asistuar në zbatimin e Projektit, Huamarrësi, përmes Entit Zbatues, përveç kur bihet dakord ndryshe me Bankën, punëson ose nxit punësimin, sipas kërkesës, dhe përdor konsulentë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme për Bankën, duke përfshirë asistimin e NJZP-së nga këta konsulentë në:

(1) rishikimin dhe përditësimin e konceptit të detajuar të Projektit, duke përfshirë edhe përfshirjen e kontrollit të sigurisë së rrugës dhe masave për rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike;

(2) mbështetjen e zbatimit;

(3) mbikëqyrjen e punimeve;

(4) zhvillimin dhe zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse të prokurimit për të ofruar mundësi efikase për trajnim në detyrë për të rinjtë (inxhinierë/studentë) gjatë fazës së ndërtimit; dhe

(5) zbatimin e Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.

(b) Huamarrësi, përmes Entit Zbatues, do ti siguroje, pa asnjë tarifë, çdo konsulenti të punësuar përmes grantit për të asistuar në çështjet që lidhen me Projektin apo operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësitë dhe mbështetjen e nevojshme për përmbushjen e funksionit të tij.

Seksioni 3.06. Shpeshtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Dorëzimit

(a) Duke nisur nga Data e Fillimit deri kur e gjithë shuma e Huasë të jetë shlyer apo anuluar, Huamarrësi, përmes Entit Zbatues, i dorëzon Bankës raportet tremujore gjatë vitit të parë pas fillimit të ndërtimit të rrugës dhe në vijim raporte çdo gjashtë muaj deri kur të gjitha seksionet rrugore në kuadër të Projektit të jenë funksionale. Pas dorëzimit të këtyre raporteve, Huamarrësi, përmes Entit Ekekutues, i dorëzon Bankës raportet vjetore për Çështjet Mjedisore dhe Sociale që lindin lidhur me Huamarrësin apo Projektin, jo më vonë se 120 ditë pas përfundimit të vitit për të cilin po raportohet. Këto raporte përfshijnë informacion për çështjet e mëposhtme specifike:

(1) informacione për përputhshmërinë e Huamarrësit me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, siç përshkruhen në Seksionet 3.04(a) dhe zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social dhe Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit;

(2) informacione për mënyrën sesi Huamarrësi ka monitoruar përputhshmërinë dhe çdo kontraktues i angazhuar për Projektin me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, si dhe Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit dhe përmbledhjen e çdo mospërputhshmërie materiale nga ky kontraktues me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, si dhe çdo masë të marrë për të korrigjuar këtë mospërputhshmëri;

(3) informacion për zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesit, i kërkuar në kuadër të Kërkesës së Performancës 10, duke përfshirë një përmbledhje të të gjitha ankesave të mara dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;

(4) informacion mbi përputhshmërinë e Huamarrësit me Legjislacionin Mjedisor dhe Social që lidhet me Projektin, duke përfshirë një përshkrim të të gjitha pretendimeve, procedurave, urdhrave të hetimit të ekzekutuara apo me të cilët Huamarrësi është kërcënuar, statusin e të gjitha Autorizimeve të nevojshme për Projektin, rezultatet e të gjitha inspektimeve të ndërmarra nga autoritetet rregullore, të gjitha shkeljet e legjislacionit në fuqi, rregulloreve dhe standardeve dhe të gjitha veprimet korrigjuese apo gjobat lidhur me këto shkelje, në përmbledhje të të gjitha njoftimeve, raporteve dhe komunikimeve të tjera për Çështje Mjedisore dhe Sociale të lidhura me Projektin që janë dorëzuar drejtpërdrejt nga Huamarrësi, përmes një Enti Zbatues apo në mënyra të tjera (të përshtatshme) drejtuar çdo autoriteti rregullator, dhe të gjitha rrethanat e tjera që rezultojnë në përgjegjësi për Huamarrësin sa i përket të gjitha Çështjeve Mjedisore dhe Sociale;

(5) informacion për administrimin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe për regjistrat e shëndetit dhe sigurisë në punë të Projektit, duke përfshirë shkallën e aksidenteve, kohës së humbur, incidenteve dhe thuajse incidenteve, të gjitha masat parandaluese apo lehtësuese të marra apo të planifikuara nga Huamarrësi, të gjithë trajnimin e personelit për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe të gjitha nismat e tjera që lidhen me administrimin e shëndetit dhe sigurisë në punë që janë zbatuar apo planifikuar nga Huamarrësi;

(6) një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve të Legjislacionit Mjedisor dhe Social që mund të ketë ndikim material në Projekt dhe

(7) kopje të të gjithë informacionit për Çështjet Mjedisore dhe Sociale që ndikon tek Projekti, të shpallur periodikisht për publikun e gjerë nga Huamarrësi, nëse zbatohet.

(b) Duke nisur nga Data e Fillimit, përmes Entit Zbatues, Huamarrësi dorëzon raportet Periodike të projektit të përcaktuara në Seksionin 4.04(a)(v) të Termave dhe Kushteve Standarde çdo tre muaj, brenda 45 ditëve nga mbyllja e periudhës për të cilën raportohet, deri në përfundim të Projektit. Këto raporte përfshijnë karakteristikat e mëposhtme specifike:

(1) Informacionin e përgjithshëm si më poshtë:

(A) procesin fizik të arritur në zbatimin e Projektit deri në atë moment të raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

(B) vështirësi ose vonesa faktike ose të pritshme në zbatimin e Projektit dhe efektin e tyre në programin e zbatimit, dhe hapat faktikë të marrë ose të planifikuar për tejkalimin e vështirësive dhe shmangien e vonesave;

(C) ndryshimet e pritshme lidhur me ditën e përfundimit të Projektit;

(D) ndryshimet kyçe të personelit në stafin e NJZP-së, konsulentëve apo kontraktuesve;

(E) çështjet që mund të ndikojnë tek kostot e Projektit dhe

(F) të gjitha zhvillimet ose veprimtaritë që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë ekonomie të cilësdo Pjese të Projektit.

(2) Një grafik me kolona të bazuar në programin e zbatimit të Projektit që tregon ecurinë e secilës Pjesë të Projektit dhe që përfshin një grafik të shpenzimeve të planifikuara dhe faktike.

(3) Pasqyra financiare që tregojnë shpenzimet e detajuara sipas secilës Pjesë të Projektit dhe Tërheqjeve, së bashku me pasqyrën që tregon:

(A) llogaritjet fillestare të kostos;

(B) llogaritjet e rishikuara të kostos, nëse ka, si dhe arsyet e ndryshimit;

(C) shpenzimet e parashikuara fillimisht dhe shpenzimet faktike deri tani;

(D) arsyet për ndryshimin e shpenzimeve faktike deri tani, krahasuar me shpenzimet e parashikuara fillimisht dhe

(E) shpenzimet e parashikuara për tremujorët e mbetur të vitit.

(4) Një deklaratë të shkurtër të situatës së përputhshmërisë me secilin përcaktim të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Menjëherë pas ngjarjes së ndonjë incidenti apo aksidenti që lidhet me Projektin, që ka ose mund të ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis ose në publik, ose në shëndetin apo sigurinë në punë, Huamarrësi informon, përmes Entit Zbatues, Bankën dhe menjëherë pas kësaj i jep Bankës njoftim, duke specifikuar natyrën e incidentit apo aksidentit dhe hapat që huamarrësi ka marrë drejtpërdrejt, përmes Entit Zbatues apo në mënyra të tjera (si të jetë e përshtatshme) për të korrigjuar situatën. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më lart,

(1) një incident ose aksident lidhet me Projektin, nëse ndodh në cilëndo vendndodhje të përdorur për Projektin, ose nëse shkaktohet nga ambientet, pajisjet, mjetet ose mjetet lundruese të përdorura ose të lidhura me Projektin (qoftë në

përdorim ose jo në një kantier të Projektit, ose qoftë në përdorim ose jo të personave të autorizuar apo të paautorizuar);

(2) një incident ose aksident konsiderohet të ketë shkaktuar ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis ose në publik, ose në shëndetin apo sigurinë në punë, nëse:

(A) cilido ligj i zbatueshëm kërkon njoftimin e cilitdo autoritet qeveritar për këtë incident apo aksident,

(B) ky incident apo aksident përfshin humbjen e jetës të kujtdo (qoftë ose jo ky person i punësuar nga Enti Zbatues),

(C) më shumë se një person (qoftë ose jo të punësuar nga Enti Ekzistues) janë lënduar rëndë dhe kanë nevojë për shtrim në spital ose

(D) ky incident ose aksident është ose mund të bëhet informacion publik përmes raportimit nga media ose në mënyra të tjera.

(d) Huamarrësi njofton menjëherë Bankën lidhur me të gjitha protestat ose peticionet e rëndësishme nga ana e punonjësve ose publikut që i drejtohet ose lidhet me Projektin dhe që mund të ketë ndikim negativ material në Projekt ose që është bërë ose mund të bëhet informacion publik përmes raportimit nga media ose në mënyra të tjera. Brenda dhjetë ditëve nga një njoftim i tillë, Huamarrësi, drejtpërdrejt ose përmes Entit Zbatues ose në mënyrë tjetër (që është e përshtatshme), i dorëzon Bankës një raport të pranueshëm që përcakton hollësisht rezultatin e hulumtimit të Huamarrësit lidhur me këtë protestë dhe të gjithë hapat e marrë ose të propozuar nga Huamarrësit drejtpërdrejt, ose përmes Entit Zbatues ose në mënyrë tjetër (që është e përshtatshme), me qëllim zgjidhjen e çështjeve të ngritura në protestë apo peticion.

NENI IV – ZOTIMET FINANCIARE

Seksioni 4.01. Regjistrat dhe Raportimi Financiar

(a) Huamarrësi përcakton detyrimin e Entit Zbatues për mirëmbajtjen e procedurave, regjistrave dhe llogarive të përshtatshme për pasqyrimin, në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtarisht të kontabilitetit dhe të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme, të veprimtarive, burimeve dhe shpenzimeve që lidhen me Projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar ecurinë e Projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të rrjedhin si pasojë e tij).

(b) Huamarrësi përcakton detyrimin e Entit Zbatues për:

(1) t'i siguruar Bankës që prej datës së fillimit të kësaj Marrëveshjeje, dhe sapo të jenë të disponueshme dhe në çdo rast brenda gjashtë muajve nga fundi i çdo Viti

Fiskal, pasqyrat e audituara financiare lidhur me Projektin, në përputhje me IFRS-në për çdo vit financiar, si dhe raportin e audituesit të përgatitur sipas objektit dhe detajeve të arsyeshme që mund të kërkohen nga Banka; dhe

(2) t'i siguruar Bankës të gjithë informacionin përkatës lidhur me regjistrat dhe llogaritë dhe auditimin e tyre përkatës, sipas kërkesave të arsyeshme të herëpashershme të Bankës.

NENI V - PEZULLIMI, PËRSHPEJTIMI, ANULIMI

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë përcaktohet për qëllimet e Seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe Kushteve Standarde:

(a) kuadri legjislativ dhe rregullator në fuqi për sektorin rrugor në territorin e Huamarrësit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar përkohësisht, shfuqizuar ose hequr dorë prej tij në një mënyrë të pamiratuar nga Banka me shkrim. [1]

Seksioni 5.02. Përshpejtimi i Maturimit

Sa më poshtë përcaktohet për qëllimet e Seksionit 7.06(f) të Termave dhe Kushteve Standarde:

(a) kuadri legjislativ dhe rregullator në fuqi për sektorin rrugor në territorin e Huamarrësit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar përkohësisht, shfuqizuar ose hequr dorë prej tij në një mënyrë të pamiratuar nga Banka me shkrim. [2]

NENI VI – HYRJA NË FUQI

Seksioni 6.01. Parakushtet për hyrjen në fuqi

Sa më poshtë përcaktohet për qëllimet e Seksionit 9.02(c) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe kushteve shtesë për Hyrjen në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimi i këtij ratifikimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe

[1] [Shënim: Huamarrësi nuk bie dakord, i detyruar nga huadhënësi, i panegociueshëm, pjesë e modelit udhëzues të marrëveshje për huanë sovrane/të pavarur. Formulimi i përfshirë në procesverbal.]
2 [Huamarrësi nuk bie dakord, i detyruar nga huadhënësi, i panegociueshëm, pjesë e modelit udhëzues të marrëveshje për huanë sovrane/të pavarur. Formulimi i përfshirë në procesverbal.]

(b) marrja e mendimit/mendimeve ligjor(e) nga Banka, sipas kërkesave të Seksionit 9.03 të Termave dhe Kushteve Standarde. Për qëllimet e Seksionit 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, mendimi ose mendimet e avokatit jepen në emër të Huamarrësit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe sa më poshtë përcaktohet si çështje shtesë që duhet të përfshihet në mendimin ose mendimet e drejtuara Bankës: konfirmimi që kërkesa e lidhur me botimin e njoftimit të ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse kërkohet nga legjislacioni shqiptar dhe për të gjitha çështjet e tjera që lidhen me këtë marrëveshje është përmbushur siç duhet.

Seksioni 6.02. Ndërprerja për Shkak të Moshyrjes nëFuqi

Data që përkon me ditën e 180-të pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e Seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standarde.

NENI VII - DISBURSIMET

Seksioni 7.01 Parakushtet për Disbursimin e Parë

(a) zhvillimi dhe nisja e veprimtarisë së Entit Zbatues të NJZP-së në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke përfshirë por pa u kufizuar në burimet e mjaftueshme dhe personelin e kualifikuar në mënyrë të përshtatshme;

(b) konsulentë të kualifikuar për të mbështetur NJZP-në gjatë zbatimit të projektit dhe mbikëqyrje inxhinierike të përcaktuar nga dhe të pranueshme për Bankën;

(c) zbatimi i pranueshëm i Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) dhe përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it lidhur me veprimtaritë e përgatitjes së Projektit;

(d) përfshirjen e rekomandimeve të këshilltarit të auditimit të sigurisë rrugore dhe masat e rezistueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në hartimin e Projektit dhe

(e) konfirmimi për sigurimin e burimeve për zbatimin e të gjitha masave të përcaktuara në Planin e Administrimit të Biodiversitetit të rënë dakord me Bankën me shkrim.

Seksioni 7.02 Parakushtet për Angazhimin e Transhit 2

(a) Banka përcakton vetëm bazuar në diskrecionin e saj, nëse Transhi 2 i vihet Huamarrësit në dispozicionn. Në çdo rast, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, ky përcaktim është objekt i përmbushjes paraprake, në formë dhe të përmbajtje të pranueshme për Bankën, të parakushteve të mëposhtme:

(1) Marrëveshja e Huasë të ketë hyrë në fuqi;

(2) Banka të ketë përfunduar kontrollin mjedisor dhe social për përputhshmërinë e segmentit të rrugës që përmban Pjesën D të Projektit me kërkesat e Bankës dhe

(3) Banka të ketë marrë prova të zbatimit të pranueshëm të Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social lidhur me Pjesën A dhe Pjesën B të Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

(b) Pasi Banka të ketë marrë provat e pranueshme të përcaktuara në Seksionin 7.02 (a) më lart dhe të ketë përcaktuar me vendim Bordi vënien të dispozicion të Transhit 2 Huamarrësit, Banka i drejton Huamarrësit një njoftim me shkrim që konfirmon vënien në dispozicion të Transhit 2.

NENI VIII - TË NDRYSHME

Seksioni 8.01. Njoftimet

(a) Sa më poshtë përcaktohet për qëllimet e Seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Nr. 3
Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Faks: +355 4 222 8405
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

Për Bankën

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria E Bashkuar

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve (Operations Administration Departmet)

Faks: +44-20-7338-6100
E-mail: oad@ebrd.com

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjorë, nënshkruajnë këtë Marrëveshje në [katër] kopje dhe e dorëzojnë në [Londër, Angli] në datën dhe vitin e përcaktuar më lart..

REPUBLIKA E SHQIPËRISË:

Nga: _____
Emri: ANILA DENAJ
Titulli: MINISTËR

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____
Emri: MATTEO COLANGELI
Titulli: DREJTOR I BERZH NË SHQIPËRI

SKEDULI 1- PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i këtij Projekti është të ndihmojë Huamarrësin për rehabilitimin dhe përmirësimin e tre segmenteve rrugore në rrjetin e vet rrugor rajonal dhe vendor. Projekti synon të përmirësojë lidhjen midis rajoneve të Shqipërisë dhe të japë kontribut për zhvillimin ekonomik dhe qasjen në shërbime shoqërore.

Projekti synon të përmirësojë infrastrukturën rrugore dhe shërbimet përgjatë zonave bregdetare në Shëngjin-Velipojë dhe Vlorë dhe në zonën lindore të Librazhd-Bulqizë, që do të forcojë zhvillimin e turizmit dhe do të lehtësojë më tej qarkullimin e mallrave dhe turistëve.

2. Projekti përbëhet nga Pjesët e mëposhtme që mund të ndryshohen, bazuar në marrëveshje me shkrim dhe herë pas here midis Bankës dhe Huamarrësit:

Pjesa A: (financohet nga Transhi 1)

rehabilitimi dhe zgjerimi i segmentit rrugor me gjatësi rreth 10,6 km, duke përfshirë dy devijime të vogla midis qytetit të Vlorës dhe Orikumit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë;

Pjesa B: (financohet nga Transhi 1)

rehabilitimi i segmentit rrugor me gjatësi rreth 13 km midis Shëngjinit dhe Baks-Rrjoll (Velipojë) në bregdetin verior të Shqipërisë;

Pjesa C: (financohet nga Transhi 1)

mbikëqyrja e punimeve për Pjesën A dhe Pjesën B dhe

Pjesa D: (financohet nga Transhi 2)

Përmirësimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Zgosht - Ura e Cerenecit me gjatësi rreth 47,1 km dhe mbikëqyrja përkatëse e punimeve.

SKEDULI 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur këtij Skeduli përcakton Kategoritë, shumën e Huasë së shpërndarë për secilën Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në çdo Kategori.

2. Pavarësisht dispozitave të pikës 1 më lart, nuk kryhet asnjë tërheqje lidhur me:

(a) shpenzimet e kryera para datës së Marrëveshjes së Huasë dhe

(b) shpenzimet e Pjesës D të Projektit deri në Datën e Disponueshmërisë së Transhit 2

Shtesë e Skedulit 2

Kategoria	**Shuma e Huasë e Shpërndarë në Valutën e Huasë**	**Përqindja e Shpenzimeve që do të Financohet**
(1) Punimet për Pjesën A dhe Pjesën B të Projektit	38.300.000 USD	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar të gjitha Taksat
(2) Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve për Pjesën A dhe Pjesën B	1.200.000 USD	100 % e vlerës së kontratës, duke përjashtuar të gjitha Taksat
(3) Punimet për Pjesën D të Projektit	9.700.000 USD	100%
(4) Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve për Pjesën D	300.000 USD	100%
(4) Komisioni Paraprak	500.000 USD	100%
Totali	**50.000.000 USD**	

SKEDULI 3 – PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

PËRDORIM ZYRTAR

Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
1.1	Rishikoni, përditësoni dhe zbatoni Manualin Operacional të Projektit (për IFN-të) dhe Projektin e Kuadrit të Menaxhimit Mjedisor & Social (KMMS) në përputhje me Kërkesat e Performancës (KP) të BERZH-it (2014) Përditësimi i Kuadrit M&S, minimalisht duhet të trajtojë kërkesat dhe vlerësimet e mëposhtme dhe në pikën 1-3 dhe të kërkojë që të vendoset një Preventiv i qartë për kërkesat M&S. Ai duhet të mbulojë kërkesat e menaxhimit të projektit mjedisor & social (M&S), duke përfshirë: • Rishikoni rreziqet M&S dhe kontrollet operacionale shoqëruese për secilin projekt	• Optimizimi i një menaxhimi mjedisor nëpërmjet një sistemi të formalizuar • Përputhshmëria me kërkesat e BERZH-it	• KP1 e BERZH-it - Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social • Praktika e mirë	Burimet e brendshme të FSHZH-së Njësia Mjedisore dhe Sociale. Hartimi i projektimit i trajtuar në detaje kur është e përshtatshme	Përpara zbatimit të Projektit	Të zhvillohet dhe zbatohet projekti i SMMS-së, duke përfshirë formatin e PMMS-së që përdoret për të gjitha projektet Të përcaktohen dhe t'u komunikohen qartë të gjithë punëtorëve rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Projektit SMMS Rishikim vjetor i projekt SMMS-ve nga FSHZH-ja FSHZH dorëzon Raportin Vjetor të Monitorimit pranë BERZH-it	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	rrugor, duke përfshirë vlerësimet strategjike për të justifikuar projektet investuese. • Krijoni një proces për të ofruar përditësime të rregullta të ndryshimeve kombëtare dhe *acquis* mjedisore të BE-së. • Përkufizoni/ përmirësoni metodologjitë standarde që do të përdoren për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale. • Menaxhimi dhe monitorimi i kontraktuesit, që duhet të përfshijë kontrolle të kushteve të punës (pagat, afatet dhe kushtet, orë pune shtesë, sigurimin e PMP-ve dhe ankesat) • Përkufizoni shprehimisht kërkesat brenda kuadrit dhe adresojini në procesin e projektimit për: vlerësimet e biodiversitetit, vlerësimi i ndikimit vizual dhe vlerësimet e cilësisë së ajrit në përputhje						

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	me KP-të e BERZH-it dhe praktikës së mirë • Shqyrtoni përtëritjen e Ndryshimit Klimatik duke përfshirë masat e rrezikut të përmbytjeve dhe ndërmerrni vlerësimet e risqeve nga rreziqet natyrore si pjesë e hartimit të projektit dhe procesit të detajuar të projektit • Miratimi i dokumentit PMMS si pjesë e rregullimeve menaxheriale të kontraktuesit që trajtojnë KP-të e BERZH-it. • Rishikoni kërkesat për të përditësuar dhe bëni publike rregullimet e gatishmërisë dhe reagimet e emergjencës. Ndani me palët përkatëse këto politika dhe shërbime të tjera të emergjencës si dhe me publikun e përgjithshëm, sipas rastit. • Zbatimi dhe monitorimi i PMMS-së dhe Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social						

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	(PVMS) • Caktoni role dhe përgjegjësi të qarta për zbatimin dhe raportimin e angazhimit të palëve të interesit						
1.2	Ofroni një Deklaratë Politikash M&S dhe komunikojani punonjësve dhe palëve të tjera të interesit	• Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	• KP1 e BERZH-it - Politikat Mjedisore dhe Sociale	Burimet e brendshme/ Sektori i Investimeve Ndërkombëtare të Njësisë Mjedisore dhe Sociale të Shoqërisë	Tremujori 2 2019	Të jenë zhvilluar dhe zbatuar Politikat M&S Prezantojini programin stafit dhe komunikojani palëve të interesit	Shihni KP1
1.3	Projekt PMMS-të duhet të bashkërendohen me KP-të e BERZH-it, Projekt Planin e Menaxhimit të Biodversitetit (PMB) dhe duhet të përcaktojë kërkesat minimale të monitorimit dhe raportimit PMMS-së specifike të kantierit do të përmbajnë parashikime mbi, por jo të kufizuar në plane dhe procedura për:	• Përputhshmëri me kërkesat rregullatore kombëtare dhe të BERZH-it	• KP1, KP2, KP3, KP4 të BERZH-it • Praktikë e mirë ndërkombëtare • Parimet Vullnetare mbi Sigurinë dhe të Drejtat e Njeriut	Burimet e brendshme të FSHZH-së Inxhinieri Mbikëqyrës i Njësisë Mjedisore dhe Sociale / NJZP Burimet e brendshme të	Gjatë nënshkrimit të kontratës me Kontraktuesin që do të angazhohet me punimet civile (detyrimet kontraktuale të Kontraktuesve)	Projekt PMMS-ja dhe Strategjia e Zëvendësimit të Biodiversitetit dorëzohen pranë BERZH-it PMMS-ja dhe planet mbështetëse miratohen nga Inxhinieri Mbikëqyrës/ FSHZH-ja përpara fillimit të punimeve	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	– menaxhimin e emetimeve në ajër – Menaxhimin e zhurmës dhe vibrimeve/dridhjeve – Mbrojtja e cilësisë së ujërave nëntokësore – Mbrojtja dhe menaxhimi i cilësisë së dheut duke përfshirë vendgrumbullimet – Mbrojtja e burimeve biologjike dhe ekologjike – Plani i Peizazhit dhe i Kthimit në Gjendjen e Mëparshme në përputhje me kërkesat e PMB-së – Planet e stabilizimit të shpateve ose metoda që adresojnë kërkesat e sigurisë dhe biodiversitetit). – Menaxhimi i mbetjeve – Menaxhimi i materialeve të rrezikshme – Efiçenca e burimeve – Masat e ripërtëritjes nga ndryshimi klimatik (vlerësimi i rrezikut të përmbytjeve, kapacitet i përshtatshëm i sistemit të kullimit në rast të reshjeve të dendura të shiut)			kontraktuesve/ Kontraktuesi/		Zbatimi i kërkesave përkatëse të BERZH-it Kërkesë për zhvillimin e PMMS-ve specifike për kantierin të përfshira në kontratat me Kontraktuesin E përfshirë në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH Evidencat e PMMS-ve Masat e duhura zbutëse të zbatuara nga Shoqëria dhe Kontraktuesi	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve , Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	– Reagimi dhe menaxhimi i derdhjeve/ incidenteve /aksidenteve – Kushtet e fuqisë punëtore dhe punës, si dhe kërkesat e mirëqenies duke përfshirë kodin e sjelljes për punëtorët (duke përfshirë dhe masa me ndjeshmëri gjinore) – Menaxhimi i ankesave të punëtorëve dhe palëve të jashtme të interesit. – Akomodimi i punëtorëve (në përputhje me dispozitat e KP2 lidhur me akomodimin e punëtorëve dhe Dokumentit Udhëzues të BERZH/ IFC-së "Akomodimi i punëtorëve: proceset dhe standardet" 2009 referuar në KP2) – Kërkesat e personelit të sigurisë ((në përputhje me dispozitat e KP 2)[1]						

[1] PMMS-ja duhet të përfshijë një standard praktik dhe sjelljeje për këtë personel në drejtim të marrjes në punë (të kryhen kontrolle të arsyeshme për t'u siguruar që ky personel nuk ka qenë i përfshirë në abuzime të mëparshme), rregullave të sjelljes (t'i kërkojë këtij personeli të veprojë brenda ligjeve në zbatim), trajnim (të sigurohet që ky personel të jetë i trajnuar siç duhet mbi përdorimin e forcës dhe sjelljes së përshtatshme), pajisjeve dhe monitorimit të këtij personeli, krijimin dhe mbajtjen e një

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	– Bërja publike e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit – Masa mbrojtëse shëndetësore dhe të sigurisë në punë – Masa mbrojtëse shëndetësore dhe të sigurisë së komunitetit duke përfshirë edhe një vlerësim të riskut shëndetësor dhe të sigurisë së komunitetit – Planet e emergjencës – Procedurat e gjetjeve rastësore – Trajnim prezantues – minimalisht duhet të përfshijë MSHS, mekanizma të ankimit, dhunën me bazë gjinore dhe trajnim mbi biodiversitetin për të gjithë punëtorët në kantier. – Strategjia e zëvendësimit të biodiversitetit dhe programi i zbatimit						

mekanizmi të efektshëm ankimi për të lejuar komunitetin dhe punëtorët e prekur që të shprehin shqetësimet rreth rregullimeve të sigurisë dhe veprimet e personelit të sigurisë).

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
1.4	FSHZH-ja do të ndërmarrë një analizë të nevojave të trajnimit mbi KP-të e BERZH-it për M&S e qëllim identifikimin e nevojave specifike të trajnimit; do të përgatisë dhe zbatojë një plan trajnimi.	• Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	• KP-të e BERZH-it	Burimet e brendshme të FSHZH-së Njësia Mjedisore dhe Sociale	Tremujori 2 2020 (analiza e nevojave të trajnimit) Tremujori 4 2020 përfundimi i programit të trajnimit	Nevojat e trajnimit Plani i trajnimit dhe buxheti përkatës Të dhënat e trajnimit	
1.5	Marrja e të gjitha lejeve dhe autorizimeve përpara fillimit të punimeve	• Përputhshmëri me kërkesat e ligjit kombëtar dhe të BERZH-it	• KP-të e BERZH-it	Burimet e brendshme Njësia Mjedisore dhe Sociale Kontraktuesit	Përpara punimeve	Regjistri i lejeve	
1.6	FSHZH-ja dhe kontraktuesit miratojnë procedurën e menaxhimit të ndryshimeve për të vlerësuar MSHS-në dhe rreziqet e punës në rast të projektimit apo ndryshimeve të punimeve	• Përputhshmëri me kërkesat e ligjit kombëtar dhe të BERZH-it	• KP-të e BERZH-it	Burimet e brendshme Njësia Mjedisore dhe Sociale Inxhinieri Mbikëqyrës/ NJZP Kontraktuesit	Përpara fillimit të punimeve	Procedura Miratimi i ndryshimeve nga IM/ NJZP	
2.1	Përfshini dispozitat e KP 2 lidhur me organizatat e punëtorëve në përditësimin e Manualit	• Përputhshmëri me kërkesat e	• KP2 e BERZH	Burimet e brendshme –	Tremujori 2 2020	Manuali operacional i përditësuar	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve , Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	Operacional të FSHZH-së	ligjit kombëtar dhe të BERZH-it		Departamenti i Burimeve Njerëzore			
2.2	Formalizoni dhe komunikojuni të gjithë punonjësve procedurën e brendshme të ankimit për shqetësime lidhur me punën në përputhje me KP2. Procedura e ankimit duhet të bëhet e ditur dhe të jetë në dispozicion për përdorimin e të gjithë punëtorëve në kantier duke përfshirë edhe kontraktuesit.	• Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	• KP2 të BERZH-it – Mekanizmi i ankesave • Dokumenti Udhëzues i BERZH-it për Menaxhimin e Ankesave	Burimet e brendshme të FSHZH-së BNJ Kontraktuesit	Përpara zbatimit të Projektit	Procesi dhe numri për ndjekjen e ankesave përfshihet në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH Prova që mekanizmi i ankimit iu është komunikuar punëtorëve Trajnimi prezantues i kontraktuesve	
2.3	Kërkojuni Kontraktuesve që të zbatojnë kërkesat përkatëse të KP 2 (politika të burimeve njerëzore, marrëdhëniet e punës, puna e fëmijëve, puna e detyruar, mosdiskriminimi dhe mundësia e barabartë, organizatat e punëtorëve, pagat, përfitimet dhe kushtet e punës, shëndeti dhe siguria në punë, akomodimi i punëtorëve, mekanizmi i ankesave, personeli i sigurimit i trajnuar mbi Parimet Vullnetare të Sigurisë dhe të	• Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	• KP2 e BERZH-it – Punëtorët jo të punësuar	Burimet e brendshme të kontraktuesve	Gjatë nënshkrimit të kontratës me Kontraktuesin që do të angazhohet me punimet civile	Dispozitat për zbatimin e kërkesave përkatëse të KP2 të përfshihen në kontratat me Kontraktuesin. Kontrolle dhe raporte periodike të kontraktuesve nga ana e FSHZH-së E përfshirë në Raportin Vjetor të Monitorimit të dorëzuar pranë BERZH	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	Drejtave të Njeriut) nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale dhe FSHZH-ja kontrollon periodikisht zbatimin e këtyre kërkesave.						
2.4	Klienti dhe kontraktuesit promovojnë politika dhe praktika lidhur me mundësi të barabarta për të çuar përpara përfshirjen e grave në përputhje me KP2 e BERZH-it me fokus në parandalimin dhe zbutjen e të gjitha formave të dhunës dhe ngacmimeve me bazë gjinore në kantier dhe pranë zonës së Projektit.	• Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	• KP2 e BERZH-it – Mundësi të barabarta	Burimet e brendshme Kontraktuesit	Gjatë nënshkrimit të kontratës me Kontraktuesin që do të angazhohet me punimet civile		
3.1	Kontraktuesi ndërmerr hartimin e një plani kryesor përpara fillimit të punimeve për zhurmën, cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, kushtet e tokës dhe kontrollet e biodiversitetit.	Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	KP 2 dhe KP 6 e BERZH-it	Kontraktuesi Për t'u rishikuar dhe miratuar nga Inxhinieri Mbikëqyrës/ NJZP	Gjatë hartimit të projektit dhe përpara punimeve në kantier	Raporti para fillimit të ndërtimit me analizën e planit kryesor dhe ndryshimet që parashikojnë zbutje specifike nëse është e nevojshme.	
4.1	Caktoni një profesionist përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë (SHSP) brenda njësisë M&S të FSHZH-së për	Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	KP4 e BERZH-it - Shëndeti dhe Siguria në Punë	Burimet e brendshme/ NJZP	Përpara zbatimit të Projektit (gjatë fazës së përgatitjes së	Zbatimi i menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë Raporte të vizitave në	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	përditësimin e manualeve dhe dokumenteve udhëzuese të FSHZH-së (duke përfshirë edhe kontraktuesit) të bashkërenduar me KP4. Profesionisti i SHSP-së do të krijojë dhe zbatojë një plan auditimi me qëllim kryerjen e kontrolleve periodike të pavarura mbi SHSP-në kantierin e punimeve të projektit.				Projektit)	kantier dhe veprime pasuese të ndërmarra. E përfshirë në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH	
4.2	FSHZH do t'u kërkojë Kontraktuesve nëpërmjet kontratave që të zhvillojnë dhe të zbatojnë Plane Menaxhimi të Trafikut dhe Sigurisë Rrugore për segmente të Projektit nën ndërtim që mbulojnë rreziqet rrugore në punë dhe komunitet. Këto Plane do të përfshijnë parashikime për, por jo të kufizuara në: inspektime të automjeteve, masa të rrezikut rrugor në punë, politika të drejtimit të automjeteve, kontrolli i këmbësorëve, itinerare të shpërndarjes,	Përputhshmëri me kërkesat kombëtare dhe të BERZH-it	KP 4 e BERZH-it - trafiku dhe Siguria në Rrugë	Burimet e brendshme të kontraktuesve	Gjatë nënshkrimit të kontratës me Kontraktuesin që do të angazhohet me punimet civile (detyrimet kontraktuale të kontraktuesve)	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Trafikut dhe Sigurisë Rrugore të përfshira në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH Nisma të sigurisë rrugore Të dhëna mbi aksidentet	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	sinjalistika, politikat e informimit të publikut, rrugë ndihmëse të dakordësuara. Automjetet e ndërtimit do t'u përmbahen rrugëve ndihmëse të dakordësuara dhe do të respektojnë kufijtë e shpejtësisë në ndërtim; Siguroni kompetencën e operatorëve të automjeteve dhe ofroni trajnimin prezantues; Minimizoni nevojën për lëvizjen prapa të automjetit Siguroni rrugë dhe hyrje veçmas në kantier (d.m.th., pa automjete) për këmbësorët; Panele informuese mbi rreziqet e sigurisë publike dhe informacion mbi kontaktin e emergjencës, afate; Krijoni kalime të përkohshme për rrugët dytësore.						
4.3	Të gjitha projektimet e	Përputhshmëri me	KP4 e BERZH-it	Burimet e	Gjatë fazës së	Prova për kryerjen e	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
	detajuara do t'i nënshtrohen Auditimit të Sigurisë Rrugore sipas Ligjit Kombëtar dhe në përputhje me dispozitat e Direktivës së BE-së 2008/96/KE, me përfshirjen e detyruar të përmirësimeve teknike dhe ekonomikisht të zbatueshme dhe kosto-efektive të sigurisë rrugore në fazën e projektimit. Në rast se nuk zbatohen rekomandimet e Auditorit të Sigurisë Rrugore, arsyet për secilin rekomandim të refuzuar do t'i raportohen Bankës. Bankës duhet t'i jepen përgjigjet përpara miratimit të projektimit të detajuar nga ana e ekspertit shtetëror përkatës.	kërkesat e BERZH-it		brendshme/ Konsulenti i projektimit	projektimit dhe gjatë operimit	Përpilimit të Auditimeve të Sigurisë Rrugore të statistikave të aksidenteve E përfshirë në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH	
5.1	Rishikoni dhe përditësoni Kuadrin e Politikave të Zhvendosjes të bashkërenduar me KP 5, dhe hartoni dhe zbatoni Planet e Zhvendosjes/ Rikthimit të Jetesës së Projektit	Përputhshmëri me kërkesat rregullatore kombëtare dhe të BERZH-it	Kërkesat e shpronësimit në Shqipëri KP5 e BERZH-it - Blerja e tokës, risistemimi jovullnetar dhe zhvendosja	Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale	Tremujori 1 2020	Një Projekt Kuadër i Politikave për Zhvendosje i përditësuar duhet dorëzuar pranë BERZH. Të dorëzohen Planet e Veprimit të Zhvendosjes/ Planet e Rikthimit të Jetesës pranë BERZH pa	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
			ekonomike			asnjë kundërshti Raporti Vjetor i Monitorimit dorëzuar pranë BERZH	
6.1	Përfshini kërkesat e përcaktuara në Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit në Projekt PMMS-në, në përputhje me kërkesat e KP 6 dhe FSHZH-ja duhet të ofrojë një strategji të zëvendësimit të biodiversitetit dhe zbatimit të programit.	Përputhshmëri me kërkesat kombëtare dhe të BERZH-it Minimizimi i rreziqeve për biodiversitetin	KP 6 e BERZH-it - Vlerësimi i Biodiversitetit dhe të Burimeve Natyrore të Gjallesave KP 6 e BERZH-it - Konservimi i Biodiversitetit	Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale e Shoqërisë Burimet e brendshme të kontraktuesve/ Kontraktuesi	Gjatë fazës së përgatitjes së Projektit Strategjia e Zëvendësimit deri në fund të Tremujorit 2 2020	Zbatimi i masave mbrojtëse të biodiversitetit dhe konservimit të përcaktuara në Lejen Mjedisore dhe Vlerësimit të Biodiversitetit Programe të zëvendësimit të biodiversitetit për t'u dakordësuar me BERZH-in. Raportet e Monitorimit dorëzuar pranë BERZH	
6.2	Caktoni një Oficer Ekologjik të punimeve për ndërmarrjen e kontrolleve para fillimit të ndërtimit, mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave të PMB-së dhe dorëzimin e raporteve mujore pranë FSHZH-së.	Përputhshmëri me kërkesat kombëtare dhe të BERZH-it Minimizimi i rreziqeve për biodiversitetin	KP6 e BERZH-it - Konservimi i Biodiversitetit	Burimet e brendshme të kontraktuesve/ Kontraktuesi Inxhinieri Mbikëqyrës	Gjatë fazës së përgatitjes së Projektit	Zbatimi i masave mbrojtëse të biodiversitetit dhe konservimit të përcaktuara në Lejen Mjedisore dhe Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit. Raportet e Monitorimit	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve , Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
						dorëzuar pranë BERZH	
6.3	Siguroni një pikë kalimi për kafshët në përputhje me rekomandimet e PMB-së për mbrojtjen e Çakallit dhe zbatoni programet monitoruese shoqëruese gjatë ndërtimit dhe operacioneve.	Përputhshmëri me kërkesat kombëtare dhe të BERZH-it Minimizimi i rreziqeve për biodiversitetin	KP6 e BERZH-it - Konservimi i Biodiversitetit	Burimet e brendshme të kontraktuesve/ Kontraktuesi Inxhinieri Mbikëqyrës Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale mbikëqyr dhe monitoron.	Të adresohet projektimi i detajuar Ndërtimi dhe operimet	Zbatimi i masave mbrojtëse të biodiversitetit dhe konservimit të përcaktuara në Lejen Mjedisore dhe Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit Raportet e Monitorimit dorëzuar pranë BERZH	
8.1	Krijoni Procedurën e Gjetjeve Rastësore në përputhje me KP 8 dhe ndajeni me Kontraktuesin. Siguroni që stafi përkatës dhe Kontraktuesit janë të trajnuar mbi kërkesat e procedurës dhe janë ndërmarrë konsultime me komunitetet e prekura dhe palë të tjera të interesit sipas rastit përkatës.	Përputhshmëri me kërkesat rregullatore kombëtare dhe të BERZH-it Minimizimi i rreziqeve për trashëgiminë kulturore	Legjislacioni vendas në fuqi lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore KP 8 e BERZH-it – Trashëgimia Kulturore	Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale Kontraktuesi	Përpara ndërtimit dhe gjatë fazës së ndërtimit	Është zhvilluar Procedura e Gjetjeve Rastësore dhe është trajnuar stafi përkatës i Shoqërisë/Kontraktuesit Janë kryer konsultime sipas nevojës Janë marrë lejet nga autoritetet përkatëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore Raporti Vjetor i Monitorimit dorëzuar	

Nr.	Veprimet	Rreziqet Mjedisore & Sociale (Detyrimet/Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat e Investimeve, Përgjegjësia	Afati kohor	Objektivi dhe Kriteret e Vlerësimit për Zbatim të Suksesshëm	Statusi
						pranë BERZH	
10.1	Zbatoni dhe monitoroni Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI) për secilin segment rrugor në përputhje me KP10 dhe kërkoni nga Kontraktuesit që të zbatojnë kërkesat e angazhimit të palëve të interesit sipas përcaktimit në PAPI dhe në veçanti përdorimin e mekanizmit të ankesave.	Menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve në komunitetet e prekura Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	KP 10 e BERZH-it - Bërja publike e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit Konventa UNECE për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Akses në Drejtësi në Çështjet Mjedisore	Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale	E përfshirë	në mënyrë të vazhdueshme në Raportin Vjetor të Monitorimit dorëzuar pranë BERZH Janë marrë raportet e monitorimit të ankesave dhe janë ndërmarrë veprimet pasuese.	
10.2	FSHZH do të mbështesë zbatimin e projektit të Bashkëpunimit Teknik të Ekoturizmit dhe do të promovojë Programin e Ekoturizmit të Qëndrueshëm dhe të ndihmojë në promovimin e grupit të Punës/ Koordinimit për të mundësuar vetë-qëndrueshmërinë.	Përputhshmëri me kërkesat e BERZH-it	KP 10 e BERZH-it - Bërja publike e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit KP 1, 2, 4, 6, 10 e BERZH-it	Burimet e brendshme/ Njësia Mjedisore dhe Sociale Fondi i Bashkëpunimit Teknik të BERZH-it	Hartimi dhe zbatimi i projektit	Zbatimi i Bashkëpunimit Teknik Aktivitete të angazhimit të palëve të interesit dhe materiale trajnuese	

Vlerësues **Njësia Mjedisore dhe Sociale**	Nertis Mero dhe Genti Cupi
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	
Nënshkrimi	
Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Ndërhyrjeve Infrastrukturore Rrugore **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**	Dritan Mehdi Agolli
Nënshkrimi	
Menaxher i Projektit **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**	Ermir Omari
Nënshkrimi	
Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**	Arben Skënderi
Nënshkrimi	

DEKRET
Nr.11476, datë 4.5.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 44/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri".

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 46/2020

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHTESË 6 MBI TREGTINË E SHËRBIMEVE TË MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EUROPËS QENDRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli shtesë 6, mbi tregtinë e shërbimeve të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11473, datë 30.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLLI SHTESË *6*
MBI TREGTINË E SHËRBIMEVE TË MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EUROPËS QENDRORE

Hyrje

Palët e Marrëveshjes për Ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (në vijim të referuara si "Palët"),

duke pasur parasysh preambulën, objektivat e përcaktuar në nenin 1 dhe kapitullin VI (nenet 26 deri 29) të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore të vitit 2006 (CEFTA 2006), në lidhje me tregtinë e shërbimeve, duke përfshirë tregtinë elektronike, Palët do të arrijnë gradualisht një liberalizim progresiv të tregjeve të shërbimeve të tyre, në përputhje me nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT);

duke pranuar se liberalizimi i mallrave dhe i shërbimeve në kuadrin e CEFTA 2006 do të shërbejë si rrugë për arritjen e objektivave të zhvillimit dhe të rritjes ekonomike në rajon, duke zgjeruar mundësitë e investimeve ndërrajonale dhe të prodhimit;

duke dëshiruar të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë ndërmjet Palëve dhe për nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në shërbime;

duke pasur parasysh se sektori i shërbimeve luan rol në rritje në ekonomitë dhe tregtinë e Palëve, me potencial të madh për të zhvilluar më tej tregtinë ndërrajonale të shërbimeve në një mënyrë reciprokisht të dobishme;

Asnjë dispozitë e këtij Protokolli nuk mund të interpretohet sikur përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse, sipas marrëveshjeve të tyre ndërkombëtare, duke përfshirë marrëveshjet e tyre ekzistuese rajonale dhe dypalëshe tregtare dhe Marrëveshjen e OBT-së,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

1. Për qëllime të këtij Protokolli:

a) "Masë" nënkupton çdo masë nga një Palë, qoftë në formën e një ligji, rregulloreje, rregulle, procedure, vendimi, veprimi administrativ ose ndonjë formë tjetër;

b) "Furnizim i një shërbimi" përfshin prodhimin, shpërndarjen, marketingun, shitjen dhe ofrimin e një shërbimi;

c) "Masat e Palëve që prekin tregtinë e shërbimeve" përfshijnë masat, në lidhje me:

i. blerjen, pagesën ose përdorimin e një shërbimi;

ii. aksesin dhe përdorimin, në lidhje me furnizimin e një shërbimi, shërbimeve që kërkohen nga këto Palë që t'u ofrohen publikut në përgjithësi;

iii. praninë, duke përfshirë praninë tregtare, e personave të një Pale për furnizimin e një shërbimi në territorin e një Pale tjetër;

d) "Prani tregtare" nënkupton çdo lloj biznesi ose ndërmarrjeje profesionale, duke përfshirë:

i. përbërjen, pjesëmarrjen e kapitalit[1] ose mbajtjen e një personi juridik; ose

ii. krijimin ose mbajtjen e një dege ose zyre përfaqësuese;

brenda territorit të një Pale për qëllimin e furnizimit të një shërbimi;

e) "Sektor" i një shërbimi nënkupton:

i. me referencë ndaj një angazhimi specifik, një ose më shumë ose të gjithë nënsektorët e atij shërbimi, siç specifikohen në skedulin e një Pale;

ii.ndryshe, tërësinë e atij sektori shërbimi, duke përfshirë të gjithë nënsektorët e tij;

[1] Termi "pjesëmarrje kapitali" nënkupton se përfshin pjesëmarrjen e kapitalit në një person juridik, me synim vendosjen ose ruajtjen e lidhjeve të qëndrueshme ekonomike.

f)"Shërbim i një Pale tjetër" nënkupton një shërbim që furnizohet:

i.nga ose në territorin e asaj Pale tjetër ose në rastin e transportit detar, nga një mjet lundrues i regjistruar sipas ligjeve të asaj Pale tjetër ose nga një person i asaj Pale tjetër, që furnizon shërbimet nëpërmjet operimit të një mjeti lundrues dhe/ose përdorimit të tij, në mënyrë të plotë ose të pjesshme; ose

ii. në rastin e furnizimit të një shërbimi nëpërmjet pranisë tregtare ose pranisë së personave fizikë, nga një furnizues shërbimi i asaj Pale tjetër;

g) "Furnizues shërbimi" nënkupton çdo person fizik ose juridik që furnizon një shërbim;[2]

h) "Furnizues monopol i një shërbimi" nënkupton çdo person, publik ose privat, i cili në tregun përkatës të territorit të një Pale është i autorizuar ose i themeluar zyrtarisht ose në fuqi nga ajo Palë si furnizuesi i vetëm i atij shërbimi;

i)"Konsumator shërbimi" nënkupton çdo person që merr ose përdor një shërbim;

j) "Person" nënkupton një person fizik ose një person juridik;

k) "Person fizik" nënkupton një shtetas të një Pale, sipas legjislacionit të saj të brendshëm;

l) "Person fizik i Palës tjetër" nënkupton një person fizik që banon në territorin e asaj Pale tjetër ose ndonjë Pale tjetër dhe që, sipas ligjit të asaj Pale tjetër: i. është shtetas i asaj Pale tjetër; ose ii. ka të drejtën e vendqëndrimit të përhershëm në atë Palë tjetër.

m) "Person juridik" nënkupton çdo person juridik të themeluar sipas rregullave ose ndryshe të organizuar sipas ligjit të zbatueshëm, qoftë për qëllim përfitimi ose ndryshe dhe qoftë i zotëruar privatisht ose shtetëror, duke përfshirë çdo korporatë, trust, partneritet, ndërmarrje të përbashkët, pronësi të vetme ose shoqatë;

n)"Person juridik i një Pale" nënkupton:

një Person juridik i krijuar në pajtim me ligjet e një Pale dhe që ka selinë, administratën qendrore ose vendin kryesor të biznesit në territorin e asaj Pale. Nëse personi juridik ka selinë ose administratën qendrore vetëm në territorin e një Pale, nuk do të konsiderohet si person juridik i asaj Pale nëse nuk angazhohet në operacione thelbësore biznesi në atë Palë;

një person juridik është:

i."I zotëruar" nga persona të një Pale, nëse më shumë se 50 për qind e interesit të kapitalit në të zotërohet me përfitim pronësie nga personat e asaj Pale;

ii."I kontrolluar" nga persona të një Pale, nëse këta persona kanë kompetencën për të emëruar një shumicë të drejtorëve të tij ose ndryshe për të drejtuar ligjërisht veprimet e tij;

iii. "Filial" me një person tjetër kur kontrollon ose kontrollohet nga ai person tjetër ose kur ai dhe personi tjetër kontrollohen nga i njëjti person;

o) "Shoqëri ndihmëse" i një personi juridik të një Pale, nënkupton një person juridik që kontrollohet efektivisht nga një person tjetër juridik i asaj Pale;

p)"Degë" e një personi juridik të një Pale nënkupton një vend biznesi që nuk ka personalitet juridik, i cili ka karakter të përhershëm, i tillë si zgjerim i një organizmi mëmë, me këshill drejtues dhe i pajisur nga pikëpamja materiale për të negociuar biznes me palë të treta, në mënyrë që këto të fundit, megjithëse në dijeni se nëse është e nevojshme, do të ketë një lidhje ligjore me organizmin mëmë, selia kryesore e të cilit ndodhet jashtë vendit, nuk duhet të ketë marrëdhënie të drejtpërdrejta me këtë organizëm mëmë, por mund të kryejë transaksione biznesi në vendin e biznesit që përbën zgjerimin;

q)"Taksa të drejtpërdrejta" përfshin taksat mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin total ose mbi elementet e të ardhurave ose të kapitalit, duke përfshirë taksat mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës, taksat mbi pasuritë, trashëgimitë dhe dhurimet, taksat mbi shumat e përgjithshme të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet, si edhe taksat mbi vlerësimin e kapitalit;

r)"Skedul" nënkupton skedulin e referuar në nenin 6 dhe në përmbajtje të shtojcës III;

[2] Kur shërbimi nuk furnizohet drejtpërdrejt nga personi juridik, por nëpërmjet formave të tjera të pranisë tregtare si një degë ose zyrë përfaqësuese, megjithatë, furnizuesit të shërbimit (d.m.th., personi juridik), nëpërmjet kësaj pranie tregtare duhet t'i akordohet trajtimi i ofruar për furnizuesit e shërbimeve sipas këtij Protokolli. Një trajtim i tillë do të shtrihet në praninë tregtare, nëpërmjet të cilit ofrohet shërbimi dhe nuk duhet të shtrihet në pjesë të tjera të furnizuesit që ndodhen jashtë territorit ku furnizohet shërbimi.

s)"Angazhim specifik" nënkupton një angazhim specifik të përcaktuar në skedulin e referuar në nenin 6;

t)"Shërbime për riparimin dhe për mirëmbajtjen e avionëve" nënkupton veprimtari të tilla, kur ndërmerren për një avion ose pjesë të tij, ndërsa tërhiqen nga shërbimi dhe nuk përfshijnë të ashtuquajturën mirëmbajtje të linjës;

u)"Shitje dhe marketing i shërbimeve të transportit ajror" nënkupton mundësitë që transportuesi ajror përkatës të shesë dhe të tregtojë lirisht shërbimet e veta të transportit ajror, duke përfshirë të gjitha aspektet e marketingu, të tilla si: kërkimi i tregut, reklamimi dhe shpërndarja; këto veprimtari nuk përfshijnë caktimin e çmimeve të shërbimeve të transportit ajror, as kushtet e zbatueshme;

v)"Shërbime të sistemit të rezervimit kompjuterik (CRS)" nënkupton shërbimet e ofruara nga sistemet e kompjuterizuara që përmbajnë informacion për skedulet, disponueshmërinë, tarifat dhe rregullat e tarifave të transportuesve ajrorë, nëpërmjet të cilëve mund të bëhen rezervime ose mund të lëshohen bileta;

ë)"Të drejta të trafikut ajror" nënkupton të drejtën për shërbime të planifikuara dhe të paplanifikuara të transportit ajror për të drejtuar dhe/ose për të transportuar pasagjerë, ngarkesë dhe postë për pagesë ose shpërblim ose qiramarrje nga, për, brenda ose mbi territorin e një Pale, duke përfshirë pikat ku do të dërgohen, rrugët që do të operohen, llojet e trafikut që do të kryhet, kapacitetin që do të ofrohet, tarifat që do të ngarkohen dhe kushtet e tyre, dhe kriteret për përcaktimin e linjave ajrore, duke përfshirë kritere të tilla si numri, pronësia dhe kontrolli.

Neni 2
Objekti dhe mbulimi

1. Ky Protokoll zbatohet për masat e miratuara ose të mbështetura nga Palët që prekin tregtinë e shërbimeve. Ai zbatohet për të gjithë sektorët e shërbimeve, përveç siç përcaktohet në paragrafin 4.

2. Për qëllime të këtij Protokolli, tregtia e shërbimeve përkufizohet si furnizimi i një shërbimi:

a)nga territori i një Pale në territorin e ndonjë Pale tjetër;

b)në territorin e një Pale te konsumatori i shërbimit të ndonjë Pale tjetër;

c)nga një furnizues shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë tregtare në territorin e ndonjë Pale tjetër;

d)nga një furnizues shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë së personave fizikë të një Pale në territorin e ndonjë Pale tjetër.

3. Për qëllimet e këtij Protokolli:

a)"Masat nga Palët" nënkupton masat e marra nga:

i. qeveritë dhe autoritetet qendrore, rajonale ose vendore; dhe

ii. organet joqeveritare në ushtrimin e kompetencave të deleguara nga qeveritë ose autoritetet qendrore, rajonale ose vendore;

Në përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve të saj sipas Protokollit, secila Palë do të marrë masa të tilla të arsyeshme që mund të jenë në dispozicion për të, në mënyrë që të garantojë respektimin e tyre nga qeveritë dhe autoritetet rajonale dhe vendore dhe organet joqeveritare brenda territorit të saj;

b)"Shërbime" përfshin ndonjë shërbim në ndonjë sektor, me përjashtim të shërbimeve të furnizuara në ushtrimin e autoritetit qeveritar;

c)"Një shërbim i furnizuar në ushtrimin e autoritetit qeveritar" nënkupton çdo shërbim që nuk furnizohet as mbi bazë tregtare, as në konkurrencë me një ose më shumë furnizues shërbimesh.

4. Në lidhje me shërbimet e transportit ajror, ky Protokoll nuk zbatohet për masat që cenojnë të drejtat e trafikut ajror ose masat që prekin shërbimet e lidhura drejtpërdrejt me ushtrimin e të drejtave të trafikut ajror. Ky Protokoll zbatohet për shërbimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes së avionëve, shitjen dhe marketingun e shërbimeve të transportit ajror dhe shërbimet e sistemit të rezervimit kompjuterik (CRS).

5.Ky Protokoll nuk zbatohet për ligjet, rregulloret ose kërkesat që rregullojnë prokurimin nga agjencitë qeveritare të shërbimeve të blera për qëllime qeveritare dhe jo me qëllim të rishitjes tregtare ose me qëllim të përdorimit në furnizimin e shërbimeve për shitje tregtare.

6.Ky Protokoll nuk zbatohet për subvencione ose grante të dhëna nga një Palë, duke përfshirë huat, garancitë dhe sigurimin me mbështetje qeveritare.

Neni 3
Trajtimi i kombit më të favorshëm

1.Secila Palë do t'u akordojë menjëherë dhe në mënyrë të pakushtëzuar shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve të çdo Pale tjetër trajtim jo më pak të favorshëm se sa trajtimi që u akordon shërbimeve të ngjashme dhe furnizuesve të shërbimeve të çdo jopale.

2.Nëse një Palë u akordon trajtim shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve, sipas një marrëveshjeje ekzistuese ose të ardhshme ndërkombëtare me një jopalë, Pala e interesuar, me kërkesën e një Pale tjetër, do të hyjë në bisedime, në mënyrë që të përfshijë në këtë Protokoll trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai i akorduar shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve, sipas marrëveshjes ndërkombëtare në fjalë.

3.Trajtimi i akorduar për shërbimet dhe furnizuesit e shërbimeve nga BE-ja, sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në ose sipas Marrëveshjes së Asociimit ndërmjet Republikës së Moldavisë dhe BE-së, përjashtohet nga detyrimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2. Trajtimi i akorduar për shërbimet dhe furnizuesit e shërbimeve nga BE-ja, sipas legjislacionit të brendshëm që një Palë ka miratuar për qëllimet e aderimit në BE, përjashtohet nga detyrimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2.

4.Ky nen nuk do të interpretohet sikur parandalon ndonjë Palë nga dhënia ose sipas avantazheve për vendet fqinje, me qëllim lehtësimin e shkëmbimeve të kufizuara te zonat kufitare fqinje të shërbimeve që prodhohen dhe konsumohen në nivel vendor.

Neni 4
Aksesi në treg

1. Në lidhje me aksesin në treg nëpërmjet mënyrave të furnizimit të identifikuara në nenin 2, paragrafi 2, secila Palë u jep shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve të ndonjë Pale tjetër, trajtim jo më pak të favorshëm se sa ai i parashikuar sipas termave, kufizimeve dhe kushteve të rëna dakord dhe të përcaktuar në pjesën e tij të skedulit.

2.Në sektorët ku ndërmerren angazhime për aksesin në treg, masat që një Palë nuk mbështet ose miraton qoftë mbi bazën e një nënndarjeje rajonale ose territorit të vet të plotë, nëse nuk specifikohet ndryshe në pjesën e tij të skedulit, përkufizohen si:

a)kufizime mbi numrin e furnizuesve të shërbimeve qoftë në formën e kuotave numerike, monopoleve, furnizuesve ekskluzivë të shërbimeve ose kërkesës së një testimi të nevojave ekonomike;

b)kufizime mbi vlerën totale të transaksioneve të shërbimeve ose të aseteve në formën e kuotave numerike ose kërkesën e një testimi të nevojave ekonomike;

c)kufizime mbi numrin total të operacioneve të shërbimeve ose mbi shumën totale të prodhimit të shërbimit të shprehur në lidhje me njësitë e përcaktuara numerike në formën e kuotave ose të kërkesës së një testimi të nevojave ekonomike;[3]

d)kufizime mbi numrin total të personave fizikë që mund të punësohen në një sektor të caktuar shërbimi ose që një furnizues shërbimi mund të punësojë dhe që janë të nevojshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me furnizimin e një shërbimi të veçantë në formën e kuotave numerike ose të kërkesës së një testimi të nevojave ekonomike;

e)masa që kufizojnë ose kërkojnë lloje specifike të personit juridik ose të ndërmarrjes së përbashkët nëpërmjet të cilëve një furnizues shërbimi mund të furnizojë një shërbim; dhe

f)kufizime mbi pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në lidhje me kufirin e përqindjes maksimale mbi ndarjen e aksioneve të huaja ose vlerën totale të investimit individual ose të përgjithshëm të huaj.

3. Asnjë Palë nuk paraqet në territorin e vet kufizime të reja mbi furnizimin e shërbimeve, siç përcaktohet nga neni 2, paragrafi 2, përveç siç parashikohet ndryshe në këtë Protokoll.

[3] Nënparagrafi 2(c) nuk mbulon masat e një Pale që kufizojnë kontributet për furnizimin e shërbimeve.

Neni 5
Trajtimi Kombëtar

1.Në sektorët e shënuar në pjesën e saj të Skedulit dhe në bazë të kushteve dhe kualifikimeve të përcaktuara në këtë Protokoll, secila Palë u akordon shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve të ndonjë Pale tjetër, në lidhje me të gjitha masat që prekin furnizimin e shërbimeve, trajtim jo më pak të favorshëm se sa u akordon shërbimeve të ngjashme të brendshme dhe furnizuesve të shërbimeve.[4]

2.Një Palë mund të përmbushë kërkesat e paragrafit 1, duke u dhënë shërbimeve dhe furnizuesve të shërbimeve të ndonjë Pale tjetër, trajtim formalisht identik ose trajtim formalisht të ndryshëm nga ai që u jep shërbimeve të ngjashme të brendshme dhe furnizuesve të shërbimeve.

3.Trajtimi formalisht identik ose trajtimi formalisht i ndryshëm konsiderohet të jetë më pak i favorshëm nëse ndryshon kushtet e konkurrencës në favor të shërbimeve ose furnizuesve të shërbimeve të Palës, në krahasim me shërbimet e ngjashme ose furnizuesit e shërbimeve të ndonjë Pale tjetër.

Neni 6
Skeduli i angazhimeve specifike

1.Secila Palë përcakton në një skedul të konsoliduar angazhimet specifike që ndërmerr sipas këtij Protokolli. Në lidhje me sektorët ku ndërmerren këto angazhime, skeduli përcakton:

a) termat, kufizimet dhe kushtet mbi aksesin në treg;

b) kushtet dhe kualifikimet për trajtimin kombëtar;

c) sipas rastit, afatin kohor për zbatimin e këtyre angazhimeve dhe

d) sipas rastit, datën e hyrjes në fuqi të këtyre angazhimeve.

2.Skeduli i angazhimeve specifike të Palëve përcaktohet në shtojcën III dhe përbën pjesë integrale të këtij Protokolli.

Neni 7
Modifikimi i Skeduleve

Palët, me kërkesë me shkrim të një Pale të njoftuar Nënkomitetit për Tregtinë e Shërbimeve, zhvillojnë konsultime për të shqyrtuar çdo kërkesë për të modifikuar një angazhim specifik të Palës kërkuese. Konsultimet do të zhvillohen brenda tre muajve, pasi pala kërkuese t'i ketë njoftuar kërkesën e saj Nënkomitetit të Tregtisë së Shërbimeve. Në konsultime, Palët synojnë të ruajnë një nivel të përgjithshëm të angazhimeve reciprokisht të favorshme jo më pak të favorshme për tregtinë se sa ato të parashikuara në Planin e angazhimeve specifike përpara këtyre konsultimeve. Çdo modifikim i angazhimeve specifike u nënshtrohet procedurave të përcaktuara në nenin 47 të CEFTA 2006.

Neni 8
Lëvizja e personave fizikë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me lëvizjen e personave fizikë që furnizojnë shërbime në një Palë, do të rregullohen nga shtojca I e këtij protokolli. Personat fizikë të mbuluar nga një angazhim specifik i një Pale lejohen të furnizojnë shërbimin në atë Palë, në përputhje me kushtet e këtij angazhimi.

2. Ky Protokoll nuk zbatohet për masat që prekin personat fizikë që kërkojnë akses në tregun e punës të një Pale, as nuk zbatohet për masat në lidhje me shtetësinë, vendbanimin ose punësimin mbi bazë të përhershme.

3. Asgjë në këtë Protokoll nuk i parandalon Palët të zbatojnë masa për të rregulluar hyrjen e personave fizikë në territorin e tyre ose qëndrimin e tyre të përkohshëm në territorin e tyre, duke përfshirë masat e nevojshme për mbrojtjen e integritetit dhe për të siguruar lëvizjen e rregullt të personave fizikë përgjatë kufijve të tyre, me kusht që këto masa të mos zbatohen në mënyrë të tillë që të anulojnë ose dëmtojnë përfitimet që i shkaktohen ndonjë Pale sipas kushteve të një angazhimi specifik.

[4] Angazhimet specifike të ndërmarra sipas këtij neni nuk interpretohen sikur i kërkojnë ndonjë Pale kompensim për avantazhe konkurruese të brendshme që rrjedhin nga karakteri i huaj i shërbimeve ose i furnizuesve përkatës të shërbimeve.

Neni 9
Transparenca

1. Çdo Palë do të botojë menjëherë dhe me përjashtim të situatave emergjente, maksimumi deri në kohën e hyrjes së tyre në fuqi, të gjitha masat përkatëse të aplikimit të përgjithshëm që lidhen ose ndikojnë në funksionimin e këtij Protokolli. Do të publikohen edhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me ose ndikojnë në tregtinë e shërbimeve në të cilat një Palë është nënshkruese.

2. Kur publikimi i përmendur në paragrafin 1 nuk është i mundur, ky informacion do të jetë ndryshe në dispozicion të publikut.

3. Secila Palë do të vendosë një pikë kontakti për shërbimet, siç parashikohet në nenin 44 të CEFTA 2006.

4. Secila Palë menjëherë dhe të paktën çdo vit do të informojë Nënkomitetin e Tregtisë së Shërbimeve për prezantimin e ligjeve, rregulloreve ose udhëzimeve administrative të reja ose ndryshimet në ato ekzistuese, të cilat prekin në nivel të konsiderueshëm tregtinë e shërbimeve të mbuluara nga angazhimet e saj specifike sipas këtij Protokolli.

5. Secila Palë, në masën që është e mundur, siguron paraprakisht informacionin për çdo masë përkatëse të aplikimit të përgjithshëm që Pala propozon të miratojë, në mënyrë që t'u mundësojë Palëve të tjera të komentojnë në lidhje me masën. Informacioni u ofrohet Palëve të tjera nëpërmjet Nënkomitetit për Tregtinë e Shërbimeve dhe pikat e kontaktit për shërbime do të jenë mjetet për këto komunikime.

6. Çdo Palë mund të njoftojë Nënkomitetin për Tregtinë e Shërbimeve për çdo masë nga çdo Palë tjetër, të cilën ai e çmon se ndikon në funksionimin e këtij Protokolli.

Neni 10
Rregullorja e Brendshme

1.Në pajtim me dispozitat e këtij Protokolli, Palët ruajnë të drejtën për të rregulluar dhe për të miratuar rregullore të reja, për të përmbushur objektivat e ligjshëm të politikave.

2.Në sektorë ku ndërmerren angazhime specifike, secila Palë garanton se të gjitha masat e aplikimit të përgjithshëm që prekin tregtinë e shërbimeve, administrohen në një mënyrë të arsyeshme, objektive dhe të paanshme.

3.a) secila Palë mban ose fillon sa më shpejt që të jetë e mundur, tribunale ose procedura gjyqësore, arbitrazhi ose administrative, të cilat parashikojnë, me kërkesën e një furnizuesi të prekur shërbimi, rishikim të menjëhershëm dhe nëse është e justifikueshme, mjete ligjore të përshtatshme për vendimet administrative që prekin tregtinë e shërbimeve. Nëse këto procedura nuk janë të pavarura nga agjencia së cilës i është besuar vendimi administrativ përkatës, Pala garanton që procedurat në fakt parashikojnë një rishikim objektiv dhe të paanshëm.

b) dispozitat e nënparagrafit (a) nuk interpretohen sikur i kërkojnë një Pale fillimin e këtyre tribunaleve ose procedurave, nëse kjo do të ishte e papajtueshme me strukturën e vet kushtetuese ose natyrën e sistemit të saj ligjor.

4.Kur kërkohet autorizim për furnizimin e një shërbimi për të cilin është ndërmarrë një angazhim specifik, autoritetet kompetente të një Pale, brenda një afati të arsyeshëm pas paraqitjes së një kërkese të konsideruar të plotë, sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme, informon aplikuesin për vendimin në lidhje me kërkesën. Me kërkesë të aplikuesit, autoritetet kompetente të Palës sigurojnë, pa vonesë të panevojshme, informacion në lidhje me statusin e aplikimit

5.Me synim garantimin që masat e lidhura me kërkesat dhe procedurat e kualifikimit, standardet teknike dhe kërkesat dhe procedurat e licencimit nuk përbëjnë barriera të panevojshme për tregtinë e shërbimeve, Nënkomiteti i Tregtisë së Shërbimeve, nëpërmjet organeve përkatëse, mund të krijojë dhe të përgatisë disiplina të nevojshme. Këto disiplina synojnë të garantojnë që këto kërkesa, ndër të tjera:

a)bazohen në kritere objektive dhe transparente, të tilla si kompetenca dhe aftësia për furnizimin e shërbimit;

b)të jenë jo më të rënda se sa është e nevojshme për garantimin e cilësisë së shërbimit;

c)në rastin e procedurave të licencimit, të mos jenë në vetvete kufizim mbi furnizimin e shërbimit.

6.a)në sektorët në të cilët një Palë ka ndërmarrë angazhime specifike, në pritje të hyrjes në fuqi të disiplinave të zhvilluara në këta

sektorë, sipas paragrafit 5, Pala nuk zbaton kërkesa licencimi dhe kualifikimi dhe standarde teknike që anulojnë ose dëmtojnë angazhimet e saj specifike, në një mënyrë që:

i.nuk pajtohet me kriteret e përcaktuara në nënparagrafët 5(a), (b) ose (c); dhe

ii.nuk mund të ishte pritur në mënyrë të arsyeshme nga ajo Palë në kohën e ndërmarrjes së angazhimeve specifike në këta sektorë.

b)në përcaktimin nëse një Palë është në pajtim me detyrimin, sipas paragrafit (a), duhet të merren në konsideratë standardet ndërkombëtare të organizatave[5] përkatëse ndërkombëtare, të zbatuara nga ajo Palë.

7.Në sektorë ku janë ndërmarrë angazhime specifike në lidhje me shërbimet profesionale, secila Palë do të parashikojë procedura të përshtatshme për verifikimin e kompetencës së profesionistëve të ndonjë Pale tjetër.

8.Palët do të rishikojnë çështje të rregullores së brendshme brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli. Me kërkesë të një ose më shumë Palëve, këto të fundit do të hyjnë në bisedime për disiplinat e rregullores së brendshme që do të përfshihen në këtë Protokoll ose në shtojcë ose ndryshe.

Neni 11
Njohja

1. Për qëllim të përmbushjes së standardeve ose të kritereve të saj përkatëse për autorizim, licencim ose certifikim të furnizuesve të shërbimeve, secila Palë shqyrton në mënyrën e duhur kërkesat nga një Palë tjetër për njohjen e arsimit ose të përvojës së marrë, kërkesave të përmbushura ose licencave, ose certifikimeve të dhëna në atë Palë tjetër. Një njohje e tillë mund të bazohet në një marrëveshje ose masë me atë Palë tjetër ose mund të jepet në mënyrë të pavarur.

2. Nëse një Palë pranon, me anë të një marrëveshjeje ose mase, arsimin ose përvojën e marrë, kërkesat e përmbushura ose licencat ose certifikimet e dhëna në territorin e një jopale, Pala do të japë mundësi të mjaftueshme për Palët e tjera që të negociojnë aderimin e tyre në një marrëveshje ose masë të tillë, qoftë ekzistuese ose të ardhshme, ose për të negociuar një marrëveshje ose masë të ngjashme me të. Nëse një Palë jep njohje në mënyrë të pavarur, ajo do të ofrojë mundësi të mjaftueshme për çdo Palë tjetër për të provuar se arsimi ose përvoja e marrë, kërkesat e përmbushura ose licencat ose certifikimet e dhëna në territorin e asaj Pale tjetër, duhet të njihen gjithashtu.

3. Një Palë nuk jep njohje në një mënyrë që do të përbënte mjet diskriminimi midis Palëve në zbatimin e standardeve ose të kritereve të saj për autorizimin, licencimin ose certifikimin e ofruesve të shërbimeve ose një kufizim të fshehur mbi tregtinë e shërbimeve.

4. Palët përfundojnë proceset e nevojshme për hartimin e marrëveshjeve ose të masave të njohjes së ndërsjellë për profesionet e rregulluara pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

Neni 12
Monopolet dhe furnizuesit ekskluziv të shërbimeve

1. Secila Palë garanton që çdo furnizues monopol i një shërbimi në territorin e vet, në furnizimin e shërbimit të monopolit në tregun përkatës, nuk vepron në një mënyrë të papajtueshme me detyrimet e asaj Pale, sipas nenit 3 dhe angazhimeve të tij specifike.

2. Nëse furnizuesi monopol i një Pale konkurron, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet një filiali, në furnizimin e një shërbimi jashtë objektit të të drejtave të tij të monopolit dhe që u nënshtrohet angazhimeve specifike të asaj Pale, kjo e fundit do të garantojë që një furnizues i tillë të mos shpërdorojë pozicionin e vet të monopolit për të vepruar në territorin e tij, në një mënyrë të papajtueshme me këto angazhime.

3. Nënkomiteti mbi Tregtinë e Shërbimeve, me kërkesë të një Pale, që ka arsye të besojë se një furnizues monopol i një shërbimi të ndonjë Pale tjetër është duke vepruar në mënyrë të papajtueshme me paragrafët 1 ose 2, mund t'i kërkojë Palës që vendos, mban ose autorizon një furnizues të tillë, të japë informacion specifik në lidhje me veprimet përkatëse.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për rastet e furnizuesve ekskluzivë të shërbimeve, ku

[5] Termi "organizata përkatëse ndërkombëtare" u referohet organizmave ndërkombëtarë, anëtarësimi i të cilëve është i hapur për organizmat ndërkombëtarë, të paktën të të gjithë anëtarëve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).

një Palë, formalisht ose praktikisht: a) autorizon ose vendos një numër të vogël të furnizuesve të shërbimeve; dhe b) kryesisht parandalon konkurrencën midis atyre furnizuesve në territorin e vet.

Neni 13
Praktikat e biznesit

1. Palët pranojnë se praktika të caktuara biznesi të furnizuesve të shërbimeve, të ndryshme nga ato që përfshihen në fushëveprimin sipas nenit 12, mund të kufizojnë konkurrencën dhe në këtë mënyrë të kufizojnë tregtinë e shërbimeve.

2. Secila Palë, me kërkesën e ndonjë Pale tjetër, hyn në konsultime, me qëllim të eliminimit të praktikave të përmendura në paragrafin 1. Pala e adresuar shqyrton një kërkesë të tillë në mënyrë të plotë dhe të kujdesshme dhe bashkëpunon nëpërmjet dhënies së informacionit jokonfidencial të vënë publikisht në dispozicion, të lidhur me çështjen në fjalë. Pala e adresuar, gjithashtu, i jep informacione të tjera Palës kërkuese, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm dhe lidhjen e një marrëveshjeje të pranueshme në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të saj nga Pala kërkuese.

Neni 14
Pagesat dhe transfertat

1.Përveç nën rrethana të parashikuara në nenin 15, një Palë nuk zbaton kufizimet mbi transfertat dhe pagesat ndërkombëtare për transaksionet rrjedhëse me një Palë tjetër, në lidhje me angazhimet e saj specifike.

2.Nëse një Palë ndërmerr një angazhim për akses në treg, në lidhje me furnizimin e një shërbimi nëpërmjet një mënyre furnizimi të përmendur në nenin 2, paragrafi 2 dhe nëse lëvizja ndërkufitare e kapitalit është pjesë thelbësore e vetë shërbimit, ajo Palë do të angazhohet në këtë mënyrë për të lejuar lëvizjen e tillë të kapitalit. Nëse një Palë ndërmerr një angazhim për akses në treg, në lidhje me furnizimin e një shërbimi nëpërmjet një mënyre furnizimi të përmendur në nenin 2, paragrafi 2, ajo Palë do të angazhohet në këtë mënyrë për të lejuar transfertat përkatëse të kapitalit në territorin e saj.

3.Asgjë në këtë Protokoll nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e Palëve, sipas Statutit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (në vijim i referuar si "FMN"), duke përfshirë përdorimin e veprimeve të shkëmbimit që janë në përputhje me statutin e FMN-së, me kusht që një Palë nuk do të vendosë kufizime mbi transaksionet kapitale në kundërshtim me angazhimet e saj specifike, në lidhje me transaksione të tilla, përveç sipas nenit 15 ose me kërkesë të FMN-së.

Neni 15
Kufizimet për ruajtjen e balancës së pagesave

1.Palët duhet të përpiqen për të shmangur vendosjen e kufizimeve mbi furnizimin e shërbimeve për ruajtjen e balancës së pagesave.

2.Çdo kufizim për ruajtjen e balancës së pagesave të miratuara ose të mbajtura nga një Palë, sipas dhe në përputhje me nenin XII të GATS-së, konsiderohet të jetë i pajtueshëm me këtë Protokoll.

Neni 16
Përjashtime të përgjithshme

Në bazë të kërkesës që masa të tilla nuk zbatohen në një mënyrë që do të përbënte një mjet diskriminimi arbitrar ose të pajustifikueshëm ndërmjet Palëve, ku mbizotërojnë kushte të ngjashme ose një kufizim të fshehur mbi tregtinë e shërbimeve, asgjë në këtë Protokoll nuk interpretohet sikur parandalon miratimin ose zbatimin nga ndonjë Palë, të masave:

a)të nevojshme për mbrojtjen e moralit publik ose ruajtjen e rendit publik;[6]

b)të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit ose të jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve;

c)të nevojshme për sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet ose rregulloret që janë të pajtueshme me dispozitat e këtij Protokolli, duke përfshirë ato, në lidhje me:

[6] Përjashtimi i rendit publik mund të referohet vetëm nëse paraqitet një kërcënim real dhe mjaftueshëm serioz ndaj një prej interesave themelorë të shoqërisë.

i.parandalimin e praktikave të rreme ose mashtruese ose për trajtimin e ndikimeve të një mospërmbushjeje të kontratave të shërbimit;

ii.mbrojtjen e privatësisë së individëve, në lidhje me përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe llogarive individuale;

iii.sigurinë;

d)të papajtueshme me nenin 5, me kusht që diferenca në trajtim të synojë garantimin e vendosjes ose të mbledhjes së barabartë ose efektive[7] të taksave të drejtpërdrejta, në lidhje me shërbimet ose furnizuesit e shërbimeve të Palëve të tjera;

e)të papajtueshme me nenin 3, me kusht që diferenca në trajtim të jetë rezultat i një marrëveshjeje për shmangien e tatimit të dyfishtë ose dispozitave mbi shmangien e tatimit të dyfishtë në ndonjë marrëveshje ose masë tjetër ndërkombëtare për të cilat Pala ka detyrim ligjor.

[7] Masat që synojnë garantimin e vendosjes ose të mbledhjes së barabartë ose efektive të taksave të drejtpërdrejta përfshijnë masat e marra nga një Palë sipas sistemit të vet tatimor, i cili:

i.zbatohet për furnizuesit jorezidentë të shërbimeve në njohje të faktit se detyrimi tatimor i jorezidentëve përcaktohet në lidhje me zërat e tatueshëm që e kanë burimin ose vendndodhjen në territorin e Palës; ose

ii.zbatohet për jorezidentët, me qëllim garantimin e vendosjes ose mbledhjes së taksave në territorin e Palës; ose

iii.zbatohet për jorezidentët ose rezidentët, me qëllim parandalimin e shmangies ose të evazionit tatimor, duke përfshirë masat e pajtueshmërisë; ose

iv.zbatohet për konsumatorët e shërbimeve të furnizuara në ose nga territori i një Pale tjetër, me qëllim garantimin e vendosjes ose të mbledhjes së taksave për këta konsumatorë që rrjedhin nga burime në territorin e Palës; ose

v.dallon furnizuesit e shërbimeve në bazë të taksës mbi zërat e tatueshëm në mbarë botën nga furnizues të tjerë shërbimesh, në njohje të diferencës në natyrën e bazës tatimore ndërmjet tyre; ose

vi.përcakton, alokon ose shpërndan përfitimet, fitimin, humbjen, zbritjen ose kreditimin e personave ose degëve rezidente ose ndërmjet personave ose degëve të ngjashme të të njëjtit person, me qëllim ruajtjen e bazës tatimore të Palës.

Kushtet ose konceptet tatimore brenda kuptimit të paragrafit (d) dhe këtij shënimi fundor përcaktohen sipas përkufizimeve të taksave dhe koncepteve ose përkufizimeve dhe koncepteve të ngjashme sipas ligjit të brendshëm të Palës që miraton masën.

Neni 17
Përjashtimet e sigurisë

1.Asgjë në këtë Protokoll nuk interpretohet që:

a)t'i kërkojë ndonjë Pale që të japë informacion, zbulimin e të cilit e konsideron në kundërshtim me interesat e saj thelbësorë të sigurisë; ose

b)të parandalojë ndonjë Palë nga marrja e ndonjë mase që e çmon të nevojshme për mbrojtjen e interesave të saj thelbësorë të sigurisë:

i.në lidhje me furnizimin e shërbimeve të kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për qëllimin e ofrimit të një infrastrukture ushtarake;

ii.në lidhje me materialet e zbërthyeshme dhe të bashkueshme të materialeve nga të cilat rrjedhin;

iii.merren në kohë lufte ose emergjence tjetër në marrëdhëniet ndërkombëtare;

ose

c)të parandalojë ndonjë Palë nga marrja e ndonjë mase në zbatim të detyrimeve të saj, sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

2.Nënkomiteti për Tregtinë në Shërbime informohet në masën më të plotë të mundshme, për masat e marra sipas paragrafëve 1(b) dhe (c) dhe për përfundimin e tyre.

Neni 18
Bashkëpunimi për tregtinë elektronike

1. Palët, duke pranuar se tregtia elektronike rrit mundësitë e tregtisë në shumë sektorë, bien dakord për të nxitur zhvillimin e tregtisë elektronike ndërmjet tyre, veçanërisht duke bashkëpunuar për çështjet e ngritura nga tregtia elektronike sipas dispozitave të këtij Protokolli.

2. Palët bien dakord që zhvillimi i tregtisë elektronike duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave, me qëllim që të sigurohet besimi i përdoruesve të tregtisë elektronike.

3. Palët bien dakord që dërgesat me mjete elektronike të konsiderohen si furnizim i

shërbimeve, në kuptimin e nenit 2, paragrafi 2(a) dhe nuk u nënshtrohen detyrimeve doganore.

4.Palët mbajnë dialog mbi çështje rregullatore të ngritura nga tregtia elektronike, të cilat, ndër të tjera, do të trajtojnë çështjet e mëposhtme:

a)njohjen e vërtetimeve të nënshkrimeve elektronike të lëshuara për publikun dhe lehtësimin e shërbimeve të certifikimit ndërkufitar;

b)përgjegjësinë e ofruesve të shërbimeve ndërmjetësuese, në lidhje me transmetimin ose ruajtjen e informacionit;

c)trajtimin e komunikimeve tregtare elektronike të pakërkuara;

d)mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e tregtisë elektronike;

e)çdo çështje tjetër të rëndësishme për zhvillimin e tregtisë elektronike.

5.Ky bashkëpunim mund të marrë formën e shkëmbimit të informacionit për legjislacionin e brendshëm përkatës të Palëve për këto çështje, si dhe për zbatimin e një legjislacioni të tillë.

Neni 19
Mohimi i përfitimeve

Një Palë mund t'i mohojë përfitimet e këtij Protokolli një furnizuesi shërbimesh të një Pale tjetër, nëse përcakton se shërbimi është duke u furnizuar në atë Palë nga një person juridik i zotëruar ose i kontrolluar nga persona të një jopale, të cilët nuk kanë operacione thelbësore biznesi në territorin e ndonjë Pale.

Neni 20
Rishikimi

1.Me objektivin e liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë në shërbime ndërmjet tyre, në veçanti duke eliminuar kryesisht të gjithë diskriminimin midis dhe ndërmjet tyre brenda një periudhe pesëvjeçare, Palët do të rishikojnë rregullisht Planin e tyre të angazhimeve specifike, duke marrë parasysh, në veçanti, çdo liberalizim autonom dhe punë të vazhdueshme nën kujdesin e OBT-së. Ky rishikim i parë duhet të zhvillohet jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

2.Rishikimet e rregullta të nivelit të liberalizimit sipas paragrafit 1 marrin parasysh vlerësimin e shkallës së shtrëngimit të masave që prekin tregtinë në shërbime, me anë të përdorimit të metodologjive të vendosura nga Banka Botërore dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Neni 21
Nënkomiteti për Tregtinë në Shërbim

Nënkomiteti për Tregtinë në Shërbim, i krijuar në bazë të nenit 41, paragrafi 5, i CEFTA 2006 lehtëson dhe zëvendëson zbatimin dhe aplikimin e Protokollit nga Palët.

Neni 22

Sipas nenit 47, paragrafi 1, të CEFTA 2006, ky Protokoll është pjesë integrale e CEFTA 2006.

Neni 23
Anekset

Anekset e mëposhtme përbëjnë një pjesë integrale të këtij Protokolli:

Aneksi I - Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizikë për qëllime biznesi;

Aneksi II - Parimet rregullatore në lidhje me telekomunikacionin;

Aneksi III - Skeduli i konsoliduar i angazhimeve të veçanta mbi tregtinë në shërbimet e palëve të CEFTA-s.

Neni 24
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në legjislacionin e brendshëm të Palëve. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen te Depozituesi.

2. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Për secilën Palë që depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ky Protokoll hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur ajo

Palë depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

4. Nëse kërkesat e saj ligjore të brendshme e lejojnë, një Palë mund ta zbatojë këtë Protokoll përkohësisht derisa ajo Palë të ketë depozituar instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, në përputhje me paragrafin 1. Çdo zbatim i përkohshëm i këtij Protokolli i njoftohet Depozituesit.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e të gjitha Palëve të CEFTA-s, të autorizuar rregullisht, kanë miratuar këtë Protokoll.

Bërë në [_____], më [data], në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila depozitohet te Depozituesi i CEFTA 2006, e cila u dërgon kopje të vërtetuara të gjitha Palëve të CEFTA-s.

ANEKSI I
HYRJA DHE QËNDRIMI I PËRKOHSHËM I PERSONAVE FIZIKË PËR QËLLIME BIZNESI

Ky aneks zbatohet nga Palët për masat në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të personelit kryesor, të trajnuarit, shitësit e shërbimeve të biznesit, furnizuesit e shërbimeve kontraktuese, profesionistët e pavarur dhe vizitorët afatshkurtër për qëllime biznesi.

SEKSIONI I
PERSONELI KRYESOR, TË TRAJNUARIT, SHITËSIT E SHËRBIMEVE TË BIZNESIT, FURNIZUESIT E SHËRBIMIT KONTRAKTUES DHE PROFESIONISTËT E PAVARUR

1. Sipas objektivave të këtij Protokolli, Palët angazhohen të lejojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të kategorive të mëposhtme të personave fizikë, në bazë të kushteve të renditura si më poshtë: a) personeli kryesor; b) të trajnuarit; c) shitësit e shërbimeve të biznesit; d) furnizuesit e shërbimeve kontraktuese; dhe e) profesionistët e pavarur.

2. Për çdo sektor të liberalizuar, në përputhje me nenin 4 të këtij Protokolli dhe në bazë të çdo rezerve të renditur në aneksin III, Palët do të lejojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të kategorive të mëposhtme të personave fizikë.

3. "Personeli kryesor" nënkupton personat fizikë të punësuar në një person juridik të një Pale, përveç një organizate jofitimprurëse, të cilët janë përgjegjës për krijimin ose kontrollin, administrimin dhe funksionimin e duhur të një ndërmarrjeje.

Personeli kryesor përfshin vizitorët e biznesit, përgjegjës për ngritjen e një ndërmarrjeje, si dhe të transferuarit brenda korporatës. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personelit kryesor lejohet për një periudhë prej gjashtë muajsh në çdo periudhë 12 muaj për vizitorët e biznesit; dhe tre vjet, në radhë të parë, për të transferuarit brenda korporatës. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për të transferuesit brenda korporatës zgjatet deri në dy vjet shtesë për një periudhë të përgjithshme që nuk tejkalon pesë vjet.

a) "Vizitorët e biznesit" (VB) nënkupton personat fizikë të cilët punojnë në një funksion të lartë në një person juridik, të cilët janë përgjegjës për krijimin e një ndërmarrjeje. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim i vendosur te Pala pritëse; dhe

b) "Të transferuarit brenda korporatës" (TBK) nënkupton personat fizikë të cilët janë punësuar nga një person juridik i një Pale ose kanë qenë partnerë në atë Palë për të paktën një vit dhe të cilët janë transferuar përkohësisht në një ndërmarrje (përfshirë shoqëritë ndihmëse, filialet ose degët) në territorin e një Pale tjetër. Personat fizikë në fjalë u përkasin një prej kategorive të mëposhtme:

c) Menaxherët janë persona fizikë të cilët punojnë në një funksion të lartë në një person juridik, marrin përsipër mbikëqyrjen ose drejtimin e përgjithshëm të biznesit, të cilët kryesisht drejtojnë menaxhimin e ndërmarrjes, përfshirë:

a) drejtimin e ndërmarrjes ose të një departamenti ose nënndarje të saj;

b) mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë mbikëqyrës, profesionistë ose drejtues; dhe

c) kanë autoritetin të rekrutojnë dhe të pushojnë nga puna personalisht ose të

rekomandojnë rekrutimin, pushimin nga puna ose veprime të tjera të personelit.

ii. Specialistët janë persona fizikë të cilët punojnë në një person juridik i cili ka njohuri të specializuara të nevojshme për prodhimin, pajisjet kërkimore, teknikat ose menaxhimin e ndërmarrjes. Në vlerësimin e këtyre njohurive, do të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për ndërmarrjen, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, që i referohet një lloji pune apo tregtie që kërkon njohuri teknike specifike, përfshirë anëtarësimin në një profesion të akreditуar.

4. "Të trajnuarit" nënkupton personat fizikë të cilët janë të punësuar nga një person juridik i një Pale për të paktën një vit, të cilët kanë një diplomë universitare dhe transferohen përkohësisht në një ndërmarrje në territorin e një Pale tjetër, për qëllime të zhvillimit të karrierës ose për të marrë trajnim mbi teknikat ose metodat e kryerjes së biznesit. Ndërmarrjes marrëse mund t'i kërkohet të paraqesë një program trajnimi i cili mbulon kohëzgjatjen e qëndrimit për miratimin paraprak, duke treguar se qëllimi i qëndrimit është për trajnim, që korrespondon me nivelin e diplomës universitare.

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për të trajnuarit do të lejohet deri në një vit.

5. "Shitës të shërbimeve të biznesit" (SHSHB) nënkupton personat fizikë të cilët janë përfaqësues të një furnizuesi të shërbimit të një Pale, të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme në territorin e një Pale tjetër, me qëllim negocimin e shitjes së shërbimeve ose mallrave, ose lidhjes së marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për atë furnizues të shërbimit. Ata nuk angazhohen të kryejnë shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim i vendosur te Pala pritëse.

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i shitësve të shërbimit të biznesit lejohet deri në gjashtë muaj në çdo periudhë 12-mujore.

6. "Furnizues të shërbimit kontraktues"(FSHK) nënkupton personat fizikë të punësuar nga një person juridik i një Pale, e cila nuk ka ndërmarrje në territorin e një Pale tjetër dhe që ka lidhur një kontratë me mirëbesim për të furnizuar shërbime me një konsumator në atë Palë tjetër që kërkon praninë në një bazë të përkohshme të punonjësve të saj në atë Palë për të përmbushur kontratën për të ofruar shërbime. Kontrata e shërbimit, e cila referohet në këtë protokoll duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat e Palës ku kontrata ekzekutohet.

Furnizuesit e shërbimeve kontraktuese, të cilëve u lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në një Palë për të furnizuar shërbimet në atë Palë, do të jenë në bazë të kushteve të specifikuara më poshtë:

a) personat fizikë duhet të angazhohen në furnizimin e një shërbimi në baza të përkohshme si punonjës të një personi juridik, i cili ka marrë një kontratë shërbimi në një Palë tjetër.

b) personat fizikë duhet të kenë të paktën dy vjet përvojë në sektorin e veçantë të veprimtarisë që është objekt i kontratës së shërbimit.

c) personat fizikë duhet të kenë kualifikime profesionale, nëse kjo kërkohet për të ushtruar një aktivitet në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e Palës ku jepet shërbimi.

d) personat fizikë nuk marrin shpërblim për furnizimin e shërbimeve, përveç shpërblimit të paguar nga punëdhënësit e tyre gjatë qëndrimit të tyre në një Palë tjetër.

e) hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizik në një Palë tjetër do të jetë për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë muaj ose për kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit, cilado periudhë që është më e vogël.

f) numri i personave të mbuluar nga kontrata e shërbimit nuk duhet të jetë më i lartë se sa kërkohet për të përmbushur kontratën, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat e Palës ku ofrohet shërbimi.

7. "Profesionistë të pavarur" (PP) nënkupton personat fizikë të angazhuar në furnizimin e një shërbimi dhe të regjistruar si të vetëpunësuar në territorin e një Pale, të cilët kanë lidhur një kontratë me mirëbesim për të furnizuar shërbime me një konsumator në një Palë tjetër, duke kërkuar praninë e tyre në mënyrë të përkohshme tek ajo Palë tjetër për të përmbushur kontratën për të ofruar shërbime.

Profesionistët e pavarur, të cilëve u lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në një Palë, për të furnizuar shërbime në atë Palë, do t'u nënshtrohen kushteve të specifikuara më poshtë:

a) Personat fizikë duhet të angazhohen në furnizimin e një shërbimi në bazë të përkohshme, si persona të vetëpunësuar të regjistruar në një Palë tjetër dhe duhet të kenë marrë një kontratë shërbimi për një periudhë që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj.

b) Personat fizikë duhet të kenë, në datën e paraqitjes së një aplikimi për hyrjen në një Palë, të paktën tre vjet përvojë profesionale në sektorin e veprimtarisë që është objekt i kontratës së shërbimit.

c) Personat fizikë duhet të kenë kualifikime profesionale, nëse kjo kërkohet për të ushtruar një veprimtari në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e Palës ku ofrohet shërbimi.

d) Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizikë në një Palë do të jetë për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore ose për kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit, cilado që është më e vogël.

8. Një Palë nuk mbështet ose miraton asnjë kufizim mbi numrin e përgjithshëm të personave fizikë, që një person juridik i një Pale tjetër mund të transferojë si personel kryesor ose të trajnuar në një sektor të veçantë në formën e kuotave numerike ose një kërkesë për një test për nevoja ekonomike ose testin e tregut të punës ose ndonjë kufizim diskriminues. Një Palë nuk kërkon që një ndërmarrje të caktojë në funksione të larta drejtuese persona fizikë të ndonjë shtetësie të veçantë.

SEKSIONI II
VIZITORËT AFATSHKURTËR PËR QËLLIME BIZNESI

1. Palët do të lehtësojnë, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës, hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të vizitorëve afatshkurtër, për qëllime biznesi nga ndonjë Palë tjetër, me qëllim kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

a) Kërkim dhe projektim: Kërkues teknikë, shkencorë dhe statistikorë, në emër të një personi juridik të vendosur në territorin e një Pale tjetër;

b) Kërkim marketingu: Personeli që kryen kërkime ose analiza, përfshirë kërkimin e tregut, në emër të një personi juridik i vendosur në territorin e një Pale tjetër;

c) Seminare trajnimi: Personeli i një personi juridik në një Palë që hyn në territorin e një Pale tjetër për të marrë trajnime mbi teknikat dhe praktikat e punës të përdorura nga persona juridikë ose organizata në atë Palë tjetër, me kusht që trajnimi i marrë të kufizohet vetëm në vëzhgimin, familjarizimin dhe udhëzimet në klasë;

d) Panairet dhe ekspozitat tregtare: Personeli që merr pjesë në një panair, me qëllim të promovimit të personit të tyre juridik ose produkteve ose shërbimeve të tij në një Palë tjetër;

e) Shitjet: Përfaqësuesit dhe agjentët e shitjeve që marrin urdhra ose negociojnë kontrata për mallra për një person juridik që ndodhet në territorin e një Pale tjetër, por që nuk japin mallra;

f) Blerja: Blerësit që blejnë për një person juridik ose personelin drejtues dhe mbikëqyrës të angazhuar në një transaksion tregtar të kryer në territorin e një Pale tjetër.

g) Takimet dhe konsultimet: Personat fizikë që marrin pjesë në takime ose konferenca ose angazhohen në konsultime me bashkëpunëtorët e biznesit.

2. Personave, të cilët angazhohen në veprimtaritë e përmendura në paragrafin 1, mund t'u lejohet hyrje dhe qëndrim i përkohshëm në një Palë si vizitorë afatshkurtër për qëllime biznesi, me kusht që: i. të mos angazhohen në shitjen e mallrave ose të shërbimeve të tyre për publikun e gjerë ose në furnizimin vetë të mallrave ose shërbimeve të tyre; ii. nuk marrin në emër të tyre asnjë shpërblim nga një burim i vendosur brenda Palës ku ata qëndrojnë përkohësisht; dhe iii. nuk angazhohen në furnizimin e një shërbimi, në kuadër të një kontrate të lidhur ndërmjet një personi juridik i cili nuk ka prani tregtare në Palën ku vizitorët afatshkurtër qëndrojnë përkohësisht për qëllime biznesi dhe një konsumatori në atë Palë.

3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i vizitorëve afatshkurtër për qëllime biznesi në territoret e Palëve, kur lejohet, do të jetë për një periudhë deri në gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore.

ANEKSI II
PARIMET RREGULLATORE NË LIDHJE ME TELEKOMUNIKACIONIN

Në vijim janë përkufizimet dhe parimet mbi kuadrin rregullator për rrjetet dhe shërbimet e telekomunikacionit.

Përkufizimet

"Telekomunikacion" nënkupton transmetimin dhe marrjen e sinjaleve nga çdo mjet elektromagnetik.

"Shërbimi i transportit publik të telekomunikacioneve" nënkupton çdo shërbim i transportit të telekomunikacioneve që kërkohet, shprehimisht ose praktikisht, nga një palë për t'iu ofruar publikut në përgjithësi. Këto shërbime mund të përfshijnë ndër të tjera telegrafin, telefonin, teleksin dhe transmetimin e të dhënave që përfshin në mënyrë tipike transmetimin në kohë reale të informacionit të furnizuar nga klienti ndërmjet dy ose më shumë pikave, pa ndonjë ndryshim nga fillimi në fund në formën ose përmbajtjen e informacionit të klientit.

"Rrjeti i transportit publik të telekomunikacioneve" nënkupton infrastrukturën publike të telekomunikacionit, e cila lejon telekomunikacionet ndërmjet dhe midis pikave të përcaktuara të ndërprerjes së rrjetit.

"Përdorues" nënkupton konsumatorin e shërbimit dhe furnizuesin e shërbimit.

"Objekte thelbësore" nënkupton objektet e një rrjeti ose shërbimi publik të transportit të telekomunikacioneve, që:

a) sigurohen ekskluzivisht ose kryesisht nga një furnizues ose numër i kufizuar furnizuesish; dhe

b) nuk mund të zëvendësohen ekonomikisht ose teknikisht për të ofruar një shërbim.

Një "furnizues kryesor" nënkupton një furnizues, i cili ka aftësinë të ndikojë materialisht në kushtet e pjesëmarrjes (duke pasur parasysh çmimin dhe ofertën) në tregun përkatës për rrjetet dhe shërbimet e telekomunikacionit, si rezultat i: a) kontrollit mbi objektet thelbësore; ose b) përdorimin e funksionit të saj në treg.

1. Masat mbrojtëse konkurruese

Parandalimi i praktikave antikonkurruese në telekomunikacione

Do të mbështeten ose do të miratohen masat e duhura, me qëllim parandalimin e furnizuesve të cilët, individualisht ose bashkërisht, janë një furnizues kryesorë nga angazhimi ose vazhdimi i praktikave antikonkurruese. Këto praktika antikonkurruese përfshijnë, në veçanti:

a) përfshirje në konkurrencë të pandershme jokonkuruese;

b) përdorimin e informacionit të marrë nga konkurrentë me rezultate antikonkurruese; dhe

c) mosvendosjen në dispozicion të furnizuesve të shërbimeve të tjera në baza kohore të informacionit teknik për objektet thelbësore dhe informacionin përkatës tregtar, të cilat për to janë të nevojshme për të siguruar shërbimet.

2.Ndërlidhja

2.1 Ndërlidhja i referohet lidhjes me furnizuesit, duke siguruar rrjete ose shërbime të transportit publik të telekomunikacioneve, në mënyrë që të lejojë përdoruesit e një furnizuesi të komunikojnë me përdoruesit e një furnizuesi tjetër dhe të kenë akses në shërbimet e ofruara nga një furnizues tjetër, ku ndërmerren angazhime specifike.

2.2 Ndërlidhja që duhet të realizohet

Ndërlidhja me një furnizues kryesor duhet të sigurohet në çdo pikë të mundshme teknike në rrjet. Kjo ndërlidhje sigurohet[8]:

a)sipas afateve, kushteve jodiskriminuese (përfshirë standardet dhe specifikimet teknike) dhe normat dhe të një cilësie jo më pak të favorshme sesa ajo e parashikuar për shërbimet e saj të ngjashme ose për shërbimet e ngjashme të furnizuesve të shërbimit jofilial ose për shoqëritë e saj ndihmëse ose filialet e tjera;[9]

b)në kohë, sipas afateve, kushteve (përfshirë standardet dhe specifikimet teknike) dhe normat e orientuara nga kosto, të cilat janë transparente, të arsyeshme, duke pasur parasysh fizibilitetin

[8] Furnizuesit e shërbimeve ose të rrjeteve që përgjithësisht nuk disponohen për publikun, siç janë grupet e përdoruesit të mbyllur, kanë të drejta të garantuara për t'u lidhur me rrjetin ose shërbimet e transportit publik të telekomunikacioneve, sipas afateve, kushteve dhe normave të cilat janë jodiskriminuese, transparente dhe të orientuar nga kostoja. Megjithatë, këto afate, kushte dhe norma mund të ndryshojnë nga afatet, kushtet dhe normat e aplikueshme për ndërlidhjen ndërmjet rrjeteve dhe shërbimeve publike të telekomunikacionit.

[9] Afatet, kushtet dhe normat e ndryshme mund të vendosen për operatorët në segmente të ndryshme të tregut, në bazë të dispozitave licencuese jodiskriminues dhe transparente, ku këto dallime mund të justifikohen objektivisht, sepse këto shërbime nuk konsiderohen "shërbime të ngjashme".

ekonomik dhe të ndarë mjaftueshëm, në mënyrë që furnizuesi të mos paguajë për komponentët ose pajisjet e rrjetit që nuk kërkon për kryerjen e shërbimit; dhe

c)sipas kërkesës, në pikat përveç pikave të ndërprerjes së rrjetit që ofrohen për shumicën e përdoruesve, sipas pagesave që pasqyrojnë koston e ndërtimit të objekteve shtesë të nevojshme.

2.3 Disponueshmëria publike e procedurave për negociatat e ndërlidhjes

Procedurat e zbatueshme për ndërlidhjen për një furnizues kryesor do të disponohen publikisht.

2.4 Transparenca e marrëveshjeve të ndërlidhjes

Secila palë do të sigurojë që një furnizues kryesor mundëson publikisht marrëveshjet e tij të ndërlidhjes ose një ofertë të referencës së ndërlidhjes.

2.5 Ndërlidhja: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Një furnizues i shërbimit që kërkon ndërlidhje me një furnizues kryesor do të ketë rekurs:

a)në çdo kohë; ose

b)pas një periudhe të arsyeshme kohore e cila është bërë e njohur publikisht për një organ të brendshëm të pavarur, i cili mund të jetë një organ rregullator sikurse referohet në paragrafin 5 më poshtë, për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me afatet, kushtet dhe tarifat e përshtatshme për ndërlidhjen, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në atë masë që këto nuk janë vendosur më parë.

3.Shërbimi universal

Çdo Palë ka të drejtë të përcaktojë llojin e detyrimit të shërbimit universal që dëshiron të mbështesë. Këto detyrime nuk konsiderohen si antikonkurruese në vetvete, me kusht që ato të administrohen në një mënyrë neutrale dhe transparente, jodiskriminuese dhe konkurruese dhe nuk janë më të rënda se sa është e nevojshmes për llojin e shërbimit universal të përcaktuar nga Pala.

4. Disponimi publik i kritereve të licencimit

Nëse kërkohet një licencë, sa më poshtë do të bëhen publike:

a) të gjitha kriteret e licencimit dhe periudha e kohës që normalisht kërkohet për të arritur një vendim në lidhje me një aplikim për licencë; dhe

b) afatet dhe kushtet e licencave individuale.

Arsyet e refuzimit të një licence do t'i njoftohen aplikantit sipas kërkesës.

5. Rregullatorët e pavarur

Organi rregullator në secilën Palë do të jetë i ndarë nga, si dhe nuk mban përgjegjësi, nga ndonjë furnizues i rrjeteve dhe i shërbimeve të telekomunikacioneve. Vendimet dhe procedurat e përdorura nga rregullatorët janë të paanshme në lidhje me të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

6. Ndarja dhe përdorimi i burimeve të pakta

Çdo procedurë për ndarjen dhe përdorimin e burimeve të pakta, përfshirë frekuencat, numrat dhe të drejtat e rrugës, kryhet në mënyrë objektive, në kohë, transparente dhe jodiskriminuese. Gjendja e tanishme e brezave të frekuencës së ndarë vihet në dispozicion publikisht, por nuk kërkohet identifikim i hollësishëm i frekuencave të ndara për përdorime të veçanta qeveritare.

ANEKSI III
SKEDUL I KONSOLIDUAR I ANGAZHIMEVE TË VEÇANTA MBI TREGTINË E SHËRBIMEVE TË PALËVE TË CEFTA-s

PROGRAM I KONSOLIDUAR I ANGAZHIMEVE TË VEÇANTA MBI TREGTINË E SHËRBIMEVE TË PALËVE TË CEFTA-s

SHËNIME SHPJEGUESE

Ky "Program i konsoliduar i angazhimeve të veçanta mbi tregtinë e shërbimeve të palëve të CEFTA-s" bazohet në listën e Kombeve të Bashkuara për klasifikimin e produkteve qendrore (CPC) që përdoret në negociatat e shërbimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë, por përfshin, gjithashtu, disa shërbime siç përshkruhet në versionin 2 të CPC-së (botimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Versioni 2).

Ky program është në përputhje me praktikën e caktimit të GATS-së dhe tregon vetëm ato sektorë dhe nënsektorë shërbimesh ku Palët ndërmarrin angazhimet e tyre. Në lidhje me aksesin në treg dhe angazhimet kombëtare të trajtimit, më poshtë jepen mënyrat e ndryshme të furnizimit të treguara në këtë Program:

Mënyra 1: Nga territori i një Pale në territorin e çdo Pale tjetër;

Mënyra 2: Në territorin e një Pale të një konsumatori të shërbimit të çdo Pale tjetër;

Mënyra 3: Nga një furnizues shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë tregtare në territorin e çdo Pale tjetër; dhe

Mënyra 4: Nga një furnizues shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë së personave fizikë të një Pale në territorin e çdo Pale tjetër.

Për qëllimet e këtij Programi, kur angazhimet janë ndërmarrë nga të gjitha Palët e CEFTA-s 2006, kjo është treguar me shënimin "Të gjitha Palët e CEFTA-s". Përndryshe, angazhimet nga palët individuale tregohen me shkurtesat e dhëna më poshtë, sipas rendit të renditura në preambulën e CEFTA 2006, por duke përjashtuar Palët që janë tërhequr nga Marrëveshja në përputhje me nenin 51.

Pala 1 - PI
Pala 2 - PII
Pala 3 - PIII
Pala 4 - PIV
Pala 5 - PV
Pala 6 - PVI
Pala 7 - PVII

A. ANGAZHIMET HORIZONTALE

1. Blerja e tokës dhe e pasurive të paluajtshme

Pala I - Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund të mos blejnë burime natyrore dhe toka bujqësore, toka shtetërore pyjore ose toka në zonat kufitare dhe ushtarake në Palës I. Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër kanë të drejtë të blejnë tokë shtetërore jobujqësore, me kusht që vlera e investimit në tokën në fjalë është tri herë më e lartë se vlera e tokës jobujqësore në Palën I.

Pala II - Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund të mos fitojnë dhe të kenë pasuri të paluajtshme në Palën II, përveç nëse prona e fituar është e lidhur me furnizimin e një shërbimi dhe me kusht të reciprocitetit midis Palës II dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është vendosur ligjërisht. Toka bujqësore mund të mos jetë në pronësi të personave fizikë ose juridikë të një Pale tjetër.

Pala III - Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër, me kushtin e reciprocitetit midis Palës III dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është vendosur ligjërisht, mund të fitojë të drejtën e ndërtesave të sheshta dhe mjediseve të biznesit dhe të drejtën për pronësinë ose dhënien me qira afatgjatë të tokës ndërtimore në territorin e Palës III. Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër mund të marrë të drejtën e qirasë afatgjatë të tokës bujqësore në territorin e Palës III, me kusht të reciprocitetit midis Palës III dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është vendosur ligjërisht. Qiratë afatgjata nuk mund të kalojnë nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet. Të gjitha blerjet kërkojnë miratimin e ministrive kompetente.

Pala IV - Mund të lejohet leja e tokës që nuk kalon nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet. Personat fizikë ose juridikë të një Pale tjetër mund të blejnë tokë në Palën IV, përveç tokës për bujqësi ose për pylltari.

Pala V - Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund të kenë pasuri të paluajtshme në Palën V, përveç tokës bujqësore dhe pasurive të paluajtshme brenda zonave të kufizuara.

Pala VI - Toka bujqësore nuk mund të jetë në pronësi të personave fizikë ose juridikë të një Pale tjetër. Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër nuk mund të fitojnë dhe të kenë pasuri të paluajtshme në Palën VI, përveç nëse prona e fituar është e lidhur me sigurimin e një shërbimi dhe me kusht të reciprocitetit ndërmjet Palës VI dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është vendosur ligjërisht. Qiratë e tokës nuk mund të kalojnë nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet.

Pala VII - Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund të fitojnë të drejta në pasuri të paluajtshme në Palën VII, përveç rasteve kur me ligj parashihet ndryshe (kufizime jodiskriminuese). Kufizimet zbatohen për tokën bujqësore dhe tokën pyjore.

2. Lëvizjet e kapitalit

Pala III - Pala III mban të drejtën për të ruajtur kufizimet, në lidhje me operacionet e depozitave rezidente dhe operacionet e kapitalit rezident, në lidhje me investimet në pasuri të paluajtshme dhe letrat me vlerë jashtë vendit.

3. Regjistrimi i shoqërive

Të gjitha Palët e CEFTA-s - Një zyrë përfaqësimi është pjesë e një shoqërie pa pasur statusin e personit juridik. Zyrat e tilla mund të angazhohen vetëm në kërkime hulumtime të tregut, aktivitete promovuese ose përfaqësuese. Ata nuk mund të kryejnë aktivitete tregtare.

Pala II - Në fushat e medieve (televizioni, radioja, gazetat), tregtia dhe prodhimi i armëve, eksplozivëve dhe pajisjeve ushtarake, përqindja e kapitalit të huaj nuk mund të jetë më shumë se dyzet e nëntë (49) për qind.

Pala VI - Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër nuk mund të ketë pronësi të shumicës në ndërmarrjet që merren me tregtinë e armëve dhe të municionit ose në ndërmarrjet e vendosura në zona të kufizuara (si: brezat kufitarë, parqet kombëtare, zonat ushtarake) dhe duhet të kenë miratimin e ministrisë kompetente për investime në raste të tilla. Personat fizikë ose juridikë të një Pale tjetër mund të krijojnë ose investojnë në ndërmarrje të tilla vetëm me një person të brendshëm që plotëson kërkesën e lartpërmendur.

4. Shërbimet publike

Të gjitha palët e CEFTA-s

Shërbimet që konsiderohen si shërbime publike në nivel kombëtar ose lokal mund të jenë subjekt i monopolit publik ose i të drejtave ekskluzive që u jepen operatorëve privatë. Këto mund të ekzistojnë në fushat e mëposhtme: shërbimet e energjisë; shërbimet e ujit; shërbimet e transportit publik dhe shërbimet ndihmëse për të gjitha llojet e transportit; shërbimet e konsulencës shkencore dhe teknike; shërbimet kërkimore dhe zhvillimore në shkencat sociale dhe humanitare; shërbimet e testimit dhe të analizës teknike; shërbimet mjedisore; shëndetin publik dhe shërbimet sociale publike; shërbimet e komunikimit dhe shërbimet e arsimit publik. Të drejtat ekskluzive për shërbime të tilla mund t'u jepen operatorëve privatë vendorë ose lokalë mbi baza preferenciale.

5. Prania e personave fizikë

Të gjitha Palët e CEFTA, përveç Palës V

Pa kufizim, përveç masave që kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të kategorive të mëposhtme të personave fizikë që ofrojnë shërbime: personeli kryesor (vizitorët e biznesit, personat e transferuar brenda korporatave); pjesëmarrësit e trajnuar; shitësit e shërbimit të biznesit; furnizuesit e shërbimeve kontraktuale; profesionistë të pavarur; dhe vizitorët afatshkurtër, për qëllime biznesi, siç përcaktohet në aneksin 1, të protokollit 6 shtesë, mbi tregtinë e shërbimeve.

Pala V

Me qëllimin e zbatimit të angazhimeve të saj sipas shtojcës 1, të protokollit 6 shtesë, mbi tregtinë e shërbimeve, Pala V nuk mund të përdorë të drejtat dhe detyrimet e saj gjatë një periudhe tranzicioni prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli për Palën V. Gjatë kësaj periudhe tranzicioni, Pala V do të zgjerojë angazhimet e mëposhtme për praninë e personave fizikë në të gjitha Palët e CEFTA-s në baza reciproke.

Pala V merr përsipër të lejojë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territorin e saj të kategorive të mëposhtme të personave fizikë:

i. Personat e transferuar brenda korporatave (ICT)

Hyrja dhe qëndrimi për një maksimum prej 3 vjetësh u jepen personave të transferuar brenda një korporate dhe filialeve/apo degëve të saj, të cilët:

a) kanë qenë të punësuar nga një person juridik të vendosur ligjërisht në një Palë tjetër për të paktën një vit menjëherë para datës së hyrjes;

b) janë transferuar përkohësisht në kontekstin e ofrimit të një shërbimi në Palën V në një filial ose degë që ofron shërbime në Palën V; dhe

c) janë menaxherë, drejtues ekzekutivë ose specialistë, siç përcaktohet më poshtë:

"Menaxherët" janë personat që punojnë në pozicione të larta, të cilët kryesisht e drejtojnë personin juridik, përfshirë: a) drejtimin e ndërmarrjes ose të departamenteve/njësive përbërëse të ndërmarrjes; b) mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë mbikëqyrës, profesionalë ose drejtues; dhe c) kanë autoritetin personalisht të punësojnë dhe të shkarkojnë ose të rekomandojnë punësimin, shkarkimin ose veprimet e tjera të personelit (të tilla si promovimi ose leja e autorizimit) dhe ushtrojnë autoritet diskrecional gjatë veprimeve të përditshme. Nuk përfshin mbikëqyrësit e linjës së parë, përveç nëse punonjësit e mbikëqyrur janë profesionistë, dhe nuk përfshin punonjësit të cilët kryesisht kryejnë detyra të nevojshme për sigurimin e shërbimit. Nuk do të kërkohet një test i nevojave ekonomike.

"Drejtuesit" ekzekutivë janë persona brenda personit juridik, të cilët kryesisht e drejtojnë menaxhimin e personit juridik, përcaktojnë qëllimet dhe politikat e personit juridik, ushtrojnë influencë të gjerë në vendimmarrje, dhe që mbikëqyren përgjithësisht ose drejtohen vetëm nga drejtuesit e nivelit të lartë, bordi i drejtorëve ose aksionarët e personit juridik. Drejtuesit ekzekutivë nuk kryejnë detyra që lidhen drejtpërdrejt me sigurimin aktual të një shërbimi apo shërbimi. Nuk kërkohet një test i nevojave ekonomike.

"Specialistët" janë persona që posedojnë njohuri të pazakonshme thelbësore për shërbimet e një njësie, pajisjet kërkimore, teknikat ose menaxhimin.

Në vlerësimin e njohurive të tilla, merret parasysh jo vetëm njohuritë specifike për ndërmarrjen, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit për sa i përket llojit të punës ose tregtisë që kërkon njohuri specifike teknike, përfshirë anëtarësimin në një profesion të akreditуar. Nuk kërkohet një test i nevojave ekonomike.

ii. Vizitorët e Biznesit (BV)

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i kategorive të mëposhtme lejohet pa aplikimin e një prove të nevojave ekonomike për një periudhë deri në 90 ditë në çdo periudhë 12-mujore:

a) shitësit e shërbimeve - personat që nuk banojnë në Palën V, që janë përfaqësues të një furnizuesi të shërbimit dhe që kërkojnë hyrje të përkohshme për qëllime të negocimit dhe kontraktimit për shitjen e shërbimeve, por që nuk janë të angazhuar vetë në shitjen e drejtpërdrejtë për publikun e gjerë ose në furnizimin vetë të shërbimeve; dhe

b) personat përgjegjës për vendosjen e një prezence tregtare - menaxherët përgjegjës për vendosjen në Palën V të një prezence tregtare të një ofruesi shërbimi të një Pale tjetër, dhe të cilët nuk janë të angazhuar në shitjen e drejtpërdrejtë ose në sigurimin e shërbimeve nëse ofruesi i shërbimit nuk ka prezencë tjetër tregtare ne palën V.

iii. Furnizuesit e Shërbimit Kontraktual (CSS)

Hyrja do t'u jepet personave fizikë të angazhuar në dhënien e një shërbimi në baza të përkohshme, si punonjës të një personi juridik pa prezencë tregtare në Palën V, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Personi juridik ka marrë një kontratë shërbimi, për një periudhë që nuk kalon 12 muaj nga një konsumator final në Palën V, nëpërmjet një procedure që garanton karakterin e mirëbesimit të kontratës;

b) Kontrata e shërbimit është në përputhje me ligjet e Palës V;

c) Personi fizik` që kërkon hyrjen duhet të ofrojë shërbime të tilla si punonjës i personit juridik që furnizon shërbimin për të paktën një vit menjëherë përpara një hyrje të tillë;

d) Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm do të jetë për një periudhë kumulative jo më shumë se 90 ditë për çdo periudhë 12-mujore ose për kohëzgjatjen e kontratës, sado që të jetë më e vogël;

e) Personi fizik duhet të ketë: a) një diplomë universitare ose një kualifikim teknik që demonstron njohuri të një niveli ekuivalent[10]; b) kualifikimet profesionale kur kjo kërkohet për të ushtruar një aktivitet në sektorin përkatës në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e Palës V; dhe c) të paktën 3 vjet përvojë profesionale në këtë sektor;

f) Angazhimi lidhet vetëm me fushën e veprimtarisë së shërbimit që është objekt i kontratës; dhe nuk jep të drejtën për të ushtruar një profesion në Palën V;

g) Numri i personave të mbuluar nga kontrata e shërbimit nuk duhet të jetë më e madhe se ajo e nevojshme për të përmbushur kontratën;

h) Nuk kërkohet një test i nevojave ekonomike; dhe

i) Kontrata e shërbimit duhet të merret në njërën nga aktivitetet e mëposhtme:

- shërbime ligjore;
- shërbimet financiare dhe kontabilitetit;
- shërbime arkitekturore, planifikim urban dhe shërbime të arkitekturës së gjelbërimit/peizazhit;
- shërbime inxhinierike, shërbime inxhinierike të integruara
- shërbimet kompjuterike dhe të ngjashme me to;
- shërbime të marketingut;
- shërbimet këshilluese të menaxhimit/menaxhmentit;
- shërbimet lidhur me konsultimin për menaxhimin/menaxhmentin;
- shërbimet e testimit dhe të analizës teknike;
- shërbimet e konsulencës shkencore dhe teknike;
- shërbimet e përkthimit;
- shërbimet mjedisore; dhe
- instalimi dhe mirëmbajtja e makinerive ose e pajisjeve.

[10] Aty ku shkalla e kualifikimit nuk është arritur në palën V, kjo e fundit mund të vlerësojë nëse kjo është ekuivalente me një grade universitare të marrë në palën V.

B.ANGAZHIME TË VEÇANTA

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIME TË AKSESIT NË TREG	KUFIZIME TË TRAJTIMIT KOMBËTAR
1. SHËRBIME TË BIZNESIT		
Shërbime Juridike/Ligjore (CPC 861)		
Shërbimet juridike/ligjore (861) - Konsulencë për juridiksionin vendor, ligjin e huaj dhe ndërkombëtar (pjesë e CPC 861) (përveç noterëve, përmbaruesve privatë dhe dokumentacionit ligjor dhe shërbimeve të certifikimit të ofruara nga siguruesit e shërbimeve të ngarkuara me funksione publike) **Pala II, Pala III, Pala V, Pala VI, Pala VII**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet juridike/ligjore (861) (përveç shërbimeve të noterëve, përmbarimit privat dhe të dokumentacionit ligjor dhe certifikimit) **Pala I**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim, përveç se gjykatësit e palës tjetër mund të shoqërohet në gjykatë nga një gjykatës i Palës I.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet juridike/ligjore (861) - Përveç konsulencës mbi juridiksionin vendor, ligjin e huaj dhe ndërkombëtar **Pala IV**	Mënyra 1 - I pakufizuar, përveç hartimit të dokumenteve ligjore; Mënyra 2 - Asnjë kufizim; Mënyra 3 - Asnjë kufizim, përveçse shërbimet ligjore mund të ofrohen vetëm nëpërmjet personave juridikë të inkorporuar në Palën IV; Mënyra 4 - Asnjë kufizim, përveç se një avokat i licencuar mund të ofrojë të gjitha shërbimet ligjore, përveç përfaqësimit në procedurën penale. Përfaqësimi në procedurën penale lejohet vetëm për avokatët e betuar	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet juridike/ligjore (861) - Konsulencë për juridiksionin vendor, ligjin e huaj dhe ndërkombëtar (pjesa e CPC 861) **Pala IV**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim, përveç kërkesave kombëtare për avokatë dhe noterë të betuar	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim, përveç atyre që tregohen në kolonën e aksesit në treg
Shërbimet financiare, të auditimit dhe kontabilitetit (CPC 862) **Pala I, Pala V, Pala IV**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet financiare, të auditimit dhe kontabilitetit (CPC 862) **Pala II, Pala VI, Pala VII**	Mënyra 1 - Asnjë kufizim, përveçse raportet zyrtare të auditimit duhet të konfirmohen nga një firmë e audituar, e regjistruar në juridiksionin e brendshëm dhe të nënshkruar nga një auditor i licencuar atje Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim, përveç atyre që tregohen në kolonën e aksesit në treg
Shërbime të auditimit (pjesë e CPC 862) **Pala III**	Mënyrat 1, 2 - Është e nevojshme përfundimi i një kontrate me një shoqëri të auditimit vendës. Një shoqëri e një Pale tjetër duhet të	Mënyra 1, 2 - Një shoqëri e auditimit e një Pale tjetër, e cila nuk është e regjistruar në Palën III, por e regjistruar

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIME TË AKSESIT NË TREG	KUFIZIME TË TRAJTIMIT KOMBËTAR
	regjistrohet në juridiksionin e saj për të ofruar shërbime auditimi. Mënyrat 3, 4 - Asnjë kufizim	për të kryer auditime në juridiksionin ku është vendosur zyra e saj kryesore, mund të kryejë auditime në Palën III vetëm në bazë të kontratës në bashkëpunim me një shoqëri vendëse të auditimit. Mënyrat 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime të taksimit (CPC 863) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime arkitekturale (CPC 8671) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime inxhinierike (CPC 8672 **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet e Integruara Inxhinjerike (CPC 8673 **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Planifikimi urban dhe shërbimet arkitekturale të gjelbërimit/peizazhit (CPC 8674) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime mjekësore dhe dentare (përjashtuar institucionet e shëndetit publik (CPC9312) **Pala I, Pala II, Pala III, Pala V, Pala VI, Pala VII**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime mjekësore dhe dentare (përjashtuar institucionet e shëndetit publik (CPC9312) **Pala IV**	Mënyrat 1, 2, 4 - Asnjë kufizim Mënyra 3 - Praktika e profesionit mjekësor nga persona të një Pale tjetër kërkon leje nga autoritetet lokale shëndetësore, bazuar në nevojat ekonomike për mjekët dhe dentistët në një rajon të caktuar.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim, përveç atyre që tregohen në kolonën e aksesit në treg
Shërbimet veterinare (CPC 932), përjashtuar institucionet publike **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet e mamive, infermierisë, fizioterapisë, personeli paramjekësor (CPC 93191), duke përjashtuar institucionet e shëndetit publik **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet kompjuterike dhe shërbimet që lidhen me to (CPC 84) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIME TË AKSESIT NË TREG	KUFIZIME TË TRAJTIMIT KOMBËTAR
Shërbime të kërkim-zhvillimit (CPC 851-853) **Pala I, Pala II, Pala IV, Pala V, Pala VI, Pala VII** **Pala III,** përveç kërkimit në fushën e identitetit historik dhe kulturor të **Palës III** të popullit dhe kombësive që jetojnë në **Palën III**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime të pasurive të paluajtshme (CPC 821 & 822) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime të marrjes dhe të dhënies me qira pa operator (CPC 83) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Marrje dhe dhënie me qira të pajisjeve të regjistrimit në studio (CPC 83109)** **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime të dhënies me qira të videokasetave dhe disqeve optike të pararegjistruara për përdorim në pajisjet e zbavitjes/reklamimit në shtëpi (CPC 83202) **Pala III**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime të reklamimit/zbavitjes (CPC 871) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Kërkim tregu dhe shërbime të sondazheve të opinionit publik (CPC 864) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime konsultimi të menaxhimit (CPC 865) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime që lidhen me konsultimet për menaxhimit (CPC 866) **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbimet e testimit dhe analizës teknike (CPC 8676) (përjashtuar shërbimet që lidhen me lëshimin e certifikatave të detyrueshme dhe dokumenteve zyrtare të ngjashme, përveç atyre që parashikohet njohja e vlefshmërisë së certifikatave ose dokumenteve të një Pale tjetër). **Të gjitha Palët e CEFTA-s**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
Shërbime që lidhen me bujqësinë gjuetinë dhe pyjet (CPC 881)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIME TË AKSESIT NË TREG	KUFIZIME TË TRAJTIMIT KOMBËTAR
Pala I, Pala III, Pala IV		
Shërbime këshillimore që lidhen me bujqësinë, gjuetinë dhe pyjet (pjesë e CPC 881) **Pala II, Pala V, Pala VI, Pala VII**	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë kufizim
